

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5400
E hënë, 12 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

Veseli: Serbia duhet ta njohë Kosovën

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", LUMIR ABDIXHIKUJ ■ FAQE 4-5



Ligji për pagat të miratohet sa më shpejt

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se Ligji për nivelizimin e pagave është domosdoshmëri për vendin. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se vetëm miratimi i këtij ligji do të mund ta prolongonte keqmenaxhimin e parasë publike në çdo institucion, në veçanti nga anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike. Sipas tij, duhet të ndërpriten shtesat për të gjitha bordet e kompanive publike. Deputeti i LDK-së ka kritikuar partitë në pushtet për mosmiratimin e Ligjit për pagat. Abdixhiku ka thënë se detyra e parë e një qeverie serioze do të duhej të ishte kursimi i parasë, që pastaj ky kursim i parasë të finançohej në shëndetësi, arsim dhe gjyqësi

AKTUALE

SBASHK-U PARALAJMËRON GREVË MË 14 SHKURT F. 6

KUVENDI I PAFUQISHËM PËRBALLË QEVERISË F. 6

KUSARI-LILA ZGJEDHET KRYETARE E ALTERNATIVËS, NËNKRYETAR ILIR DEDA F. 7

RASTI I OLIVER IVANOVIQIT, PROKURORIA KËRKON PARABURGIM PËR POLICËT F. 10

EKONOMI

KODI TELEFONIK +383 DO T'I SJELLË PËRFITIME TË MËDHA EKONOMIKE KOSOVËS F. 9

PËRFAQËSUESIT E BQK-SË NJOFTOHEN NGA AFËR RRETH PAGESAVE ME KARTELA NË STAMBOLL F. 9

KULTURË

MË 16 SHKURT ÇELET EKSPOZITA RETROSPEKTIVË E PIKTORES ALIJE VOKSHI NË GMK F. 13

SPORT

SUKSESET E XHUDOS S'KANË TË NDALUR F. 18

SHTYHET DEBUTIMI I TAHIRIT NË LOJËRAT OLIMPIKE DIMËRORE F. 18

Opozita kërkon zgjedhje të reja

Përfaqësuesit e subjekteve politike në opozitë janë shprehur të gatshme për zgjedhje të parakohshme parlamentare. Ata e kanë kritikuar Qeverinë Haradinaj për izolim të vendit

dhe paaftësi, duke thënë se pranvera duhet t'i sjellë vendit zgjedhje të reja. Por, këto pretendime të opozitës i kanë hedhur poshtë zyrtarët e partive në pushtet ■ FAQE 3



Daniel Serweri porositi Kosovën ta ratifikojë demarkacionin

FAQE 3

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Veseli: Serbia duhet ta njohë Kosovën

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet të nënshkruajnë një marrëveshje ligjërish të detyrueshme, pasi është një kusht për integrimin evropian të të dyja vendeve, që është përcaktuar edhe nga Strategjia e BE-së për zgjerim dhe nuk është e arsyeshme që politikanët e moderuar në Serbi të mos jenë në gjendje ta njohin realitetin dhe pavarësinë e Kosovës



PRISHTINË, 11 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka dhënë një intervistë për agjencinë kroate të lajmeve, "HINA", gjatë vizitës zyrtare në Kroaci, ku ka folur për dialogun me Serbinë, Gjykatën Speciale, ushtrinë dhe vrasjen e Oliver Ivanoviqit.

Gjatë kësaj interviste i pari i Kuvendit është pyetur nga gazetarët kroatë për mundësinë që Specialja t'i akuzojë ish-komandantët e UÇK-së që tani janë liderët e Kosovës. "Ne e dimë se kush ishte agresori dhe kush viktimë. Por Kosova do t'i përmbushë të gjitha detyrimet e saj ndërkombëtare. Realisht me themelimin e kësaj gjykate ne kemi dëshmuar gatishmërinë tonë për të punuar në këtë drejtim", ka qenë përgjigjja e Veselit.

Më tutje, Veseli ka thënë që Kosova dhe Serbia duhet të nënshkruajnë një marrëveshje ligjërish të detyrueshme, pasi është një kusht

për integrimin evropian të dyja vendeve, që është përcaktuar edhe nga Strategjia e BE-së për zgjerim. "Nuk është e arsyeshme që politikanët e moderuar në Serbi të mos jenë në gjendje ta njohin realitetin dhe pavarësinë e Kosovës. Por çfarë duhet të bëjmë, është që të lëvizim larg konflikteve me fqinjët", ka deklaruar Veseli.

Duke folur për dialogun në Bruksel, Veseli është zotuar edhe për formimin e bashkësisë së komunave me shumicë serbe. "Dhe ne kemi vështirësitë tona, por jemi të gatshëm për t'i kapërcyer. E respektojmë Serbinë si shtet sovran dhe jemi të vendosur që qytetarët tanë të çdo komuniteti të jenë të integruar në çdo kuptim", ka thënë Veseli. Kryeparlamentari Veseli në këtë intervistë ka folur edhe për ushtrinë. Sipas tij, formimi i ushtrisë për një shtet të pavarur është i pashmangshëm. "Kosova

është shtet i pavarur dhe sovran, dhe transformimi në forcat e armatosura është proces i pashmangshëm", ka thënë Veseli. Ai ka pohuar se ushtria e Kosovës nuk do të jetë kërcënim për askënd dhe do të kontribuojë në stabilitetin e gjithë Kosovës.

Veseli ka thënë se të gjitha veprimet do të merren në koordinim me mbështetjen e Amerikës dhe të NATO-s. Krejt në fund, Kadri Veseli ka thënë se vrasja e politikanit serb Oliver Ivanoviq ishte "llogari e brendshme serbe". "Ky ishte një akt kriminal kundër stabilitetit të Kosovës, pavarësisht se kush e ka kryer. Kjo është hera e parë që situata shkakton terror psikologjik të serbëve. Unë nuk paragjykoj se kush është përgjegjës, por kjo nuk është në interes të shqiptarëve dhe serbëve", ka thënë Veseli. Ai ka premtuar se Kosova do t'i sjellë para drejtësisë kryesit e kësaj veprë.

LAJME SHKURT

Komisionari Avramopoulos viziton Tiranën

TRANË, 11 SHKURT - Dimitris Avramopoulos, komisionari për çështjet e brendshme, migracionin dhe shtetësinë në Bashkimin Evropian, do të zhvillojë një vizitë zyrtare në Tiranë. Avramopoulos do të takohet me kryeministrin Edi Rama, ministrin e Jashtëm Ditmir Bushati dhe ministrin e Brendshëm Fatmir Xhafaj lidhur me bashkëpunimin me Bashkimin Evropian mbi emigracionin, sigurinë dhe menaxhimin e kufirit. Ata do të dalin në konkluzione, që do të bëhen të ditura gjatë një konference të përbashkët me ministrin Fatmir Xhafaj sot (e hënë).



Avramopoulos do të takohet edhe me kryepeshkopin e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, Anastas Janullatos, të dielën në mbrëmje. Vizita e komisionarit grek të BE-së vjen në momentet kur Shqipëria prej hapjen e negociatave me BE-në dhe ka bërë disa hapa për të çliruar nga ngërçi marrëdhëniet me Greqinë.

Avramopoulos, tani komisionar i BE-së, ka mbajtur postet e ministrit të Mbrojtjes së Greqisë, ministrit të Punëve të Jashtme etj.

Shqipëria i ka përmbushur kushtet për integrimin në BE

TRANË, 11 SHKURT - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka publikuar të dielën raportin për vitin 2017 mbi ecurinë e procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në raportin e plotë të MEPJ-së thuhet se Shqipëria në tërësi ka përmbushur kushtet. Mes të tjerash, në dokumentin në fjalë thuhet se ka vijuar procesi i përafërimit të legjislacionit të Shqipërisë me BE-në, ndërsa reforma në drejtësi është një nga reformat më të thella të ndërmarra.

Gjithashtu, nënvizohet fakti se vettingu ngelet një nga pikat kyçe për hapjen e negociatave, ku shpesh herë është folur se në pranverë do të ketë diçka konkrete.



Ligji për gjuhët, partitë në koordinim me Xhaferin

SHKUP, 11 SHKURT - Kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, sot (e hënë) pritet t'i mbledhë koordinatorët e grupeve parlamentare për të diskutuar për debatin lidhur me amendamentet e VMRO DPMNE-së për Ligjin e gjuhëve. Nga BDI

thonë se bashkë me LSDM-në po punojnë në harmonizimin e hapave të mëtejshme me qëllim të moszgjatjes së debatit dhe miratimit të ligjit sa më shpejt. "Ligji është në fazën e pakthyeshme sa i takon procesit të miratimit të tij. Ata që tentojnë ta pengojnë janë

të vetëdijshëm për këtë fakt, por e bëjnë për aspekte propagandistike, mirëpo ky veprim do t'u kthehet pikërisht atyre me izolim edhe më të madh vendor dhe ndërkombëtar. Për momentin po harmonizohen veprimet e mëtuftjeshme mes partnerëve të

koalicionit dhe së shpejti ligji do të miratohet ashtu siç u miratua dy herë në Kuvend", kanë thënë nga BDI-ja.

Ligji për përdorimin e gjuhëve është temë kryesore edhe në bisedimet që po zhvillohen mes grupeve punuese të bllokut

maqedonas. Këtë për herë të parë e pranuan edhe në VMRO DPMNE. Ligji për gjuhët u kthye në Kuvend në lexim të tretë pasi presidenti Gjorgje Ivanov refuzoi të dekretojë të njëjtën me arsyetimin se bie ndesh me Kushtetutën.

Pranvera shihet si opsion i mbajtjes së zgjedhjeve të reja

Opozita kërkon zgjedhje të reja

Përfaqësuesit e subjekteve politike në opozitë janë shprehur të gatshme për zgjedhje të parakohshme parlamentare. Ata e kanë kritikuar Qeverinë Haradinaj për izolim të vendit dhe paaftësi, duke thënë se pranvera duhet t'i sjellë vendit zgjedhjet e reja. Por, këto pretendime të opozitës i kanë hedhur poshtë zyrtarët e partive në pushtet

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 SHKURT - Subjektet politike opozitare kanë filluar t'i tregojnë shenjat e para se duan që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Zyrtarët e partive opozitare e kanë kritikuar Qeverinë Haradinaj për paaftësi në punë, duke thënë se e vetmja zgjidhje në këtë moment për Kosovën është mbajtja e zgjedhjeve të reja në këtë pranverë.

Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se Qeveria Haradinaj ka thyer rekordet në degradimin e Kosovës. Sipas tij, kjo Qeveri duhet ta ratifikojë demarkacionin me Malin e Zi dhe të japë dorëheqje. "Presim dhe kërkojmë që shpejt të procedohet marrëveshja për demarkacionin në Kuvend. Lidhja Demokratike e mbështet këtë marrëveshje plotësisht. Pas votimit të demarkacionit, Qeveria të japë dorëheqje dhe vendi të

shkojë në zgjedhje të reja. Shteti duhet të lirohet nga kjo klasë politike e padijshme. Ne po përgatitemi për Qeverinë e ardhshme", ka thënë Hoti.

Edhe Lëvizja Vetëvendosje është treguar e gatshme për mocion mosbesimi ndaj kësaj Qeverie, nëse një gjë e tillë është e nevojshme. "Ne do të kërkojmë mocion atëherë kur të shohim se është e arsyeshme. Mendoj se në këtë drejtim nuk do të ketë ngutje. Të shohim se deri në çfarë shkalle i bënë keq vendit ky koalicion qeverisës. Nëse ne e shohim këtë natyrisht se do të veprojmë", ka thënë për "Epokën e re" deputeti i LV-së, Ali Lajçi.

Më këmbëngulëse në këtë drejtim është treguar kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila. Ajo ka thënë për "Epokën e re" se nëse kjo Qeveri nuk e rrezon veten dhe në mungesë të konsensusit, opozita do të organizojë mocion të mosbesimit ndaj saj. "Alternativa do të jetë pjesë e të gjitha iniciativave të partive opozitare, të cilat për qël-



lim kanë rrezimin e Qeverisë dhe krijimin e një qeverie tjetër, gjegjësisht shkuarjen e vendit në zgjedhje të parakohshme parlamentare. E vetmja zgjidhje është të përcaktohet afati i rrezimit të kësaj Qeverie dhe që sa më shpejt të jetë e mundur të organizohen zgjedhjet e reja në mënyrë që vendi t'i lirohet frymëmarrja dhe secili qytetar të ketë një perspektivë më të ndritshme prej kësaj të zymtës që e ka me Qeverinë aktuale", ka thënë Kusari-Lila. Ndërsa deputeti i pavarur Korab Sejdiu qeverinë aktuale e ka vlerësuar skandalozë, duke thënë se pranvera duhet t'i sjellë vendit zgjedhje të reja. "Qeveria po u

hedh hi syve të qytetarëve dhe nuk po merret me problemet e vendit. Do të duhej që populli të krijojë një aleancë me klasën e re politike, në mënyrë që të fillojë një pranverë kosovare dhe sa më shpejt t'ia këpusë jetën kësaj qeverie shkatërruese. Me shpresë që të dalë një klasë e re politike për t'i sjellë Kosovës ditë më të mira. Shpresoj që në pranverë të kemi zgjedhje të reja", ka thënë Sejdiu.

Por, këto pretendime të opozitës i ka hedhur poshtë deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj. Ai ka deklaruar për "Epokën e re" se ajo çka po bëjnë subjektet

politike opozitare ndaj Qeverisë Haradinaj është më shumë se kundërshtim politik. "Tashti ta sulmosh Ramush Haradinajn se po e izolon vendin dhe është kundër liberalizimit të vizave, kjo është hipokrizi e madhe. Ta akuzosh Haradinajn se po e izolon vendin, pikërisht në ditën kur Kosova merr mbështetje të fuqishme nga ShBA-ja dhe presidenti Trump, edhe vlerësim për punën e institucioneve të vendit, është diçka më shumë se një kundërshtim politik. Pyetini ata çfarë kanë dashur të thonë me këto akuza dhe, për më shumë, çfarë pretendojnë me to", ka thënë Nitaj.

Daniel Serweri porositi Kosovën ta ratifikojë demarkacionin



PRISHTINË, 11 SHKURT - Profesori në Universitetin John Hopkins në Uashington, Daniel Serwer, ka thënë se Kosova ka të arritura të mira në dhjetëvjetorin e pavarësisë, duke i krijuar institucionet themelore të një shteti të pavarur dhe sovran. Por, sipas tij, duhen edhe 10 vjet të tjera që shteti të kompletohet dhe konsolidohet plotësisht.

Në intervistën për "REL" ai ka theksuar se tërheqja e legjislacionit për Tribunalin Special do të jetë veprim katastrofal për Kosovën. "Mendoj se Kosova ka të arritura të mira. I ka krijuar institucionet themelore të një shteti të pavarur dhe sovran. E ka qeverinë, kuvendin e vet, Gjykatën Kushtetuese, i ka komunat, ndërsa sistemi i decentralizimit është mjaft efektiv. Megjithatë, rruga përpara është ende e gjatë... Me gjasë, edhe 10 vjet të tjera, para se të themi se shteti është kompletuar dhe konsoliduar krejtë-

sisht. Sfida të mëdha janë integrimi i pjesës veriore, ndërtimi i një force minimale të sigurisë, që do ta mbrojtë integritetin territorial të vendit, së paku për një kohë të shkurtër dhe, sinqerisht, një sistem të drejtësisë të fuqishëm dhe të pavarur. E gjithë kjo kërkon një kohë të gjatë për t'u arritur", ka thënë Serweri.

Ai ka folur edhe për çështjen e demarkacionit me Malin e Zi. "Jam në favor të marrëveshjes së demarkacionit. Mendoj se me të vërtetë asgjë nuk humbet duke e miratuar atë. Mendoj se ishte gabim i madh shtyrja e ratifikimit dhe shpresoj se do të lëvizet përpara", ka thënë ai, duke dhënë edhe një këshill për deputetët e Kuvendit të Kosovës. "Këshilla ime është: kryejeni këtë punë pasi Kosova shumë më tepër përfiton me liberalizim të vizave sesa çfarëdo që mund ta humbë me demarkacion", ka thënë Serweri.

Flet për "Epokën e re", Lumir Abdixhiku

Ligji për pagat të mi



Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se Ligji për nivelizimin e pagave është domosdoshmëri për vendin. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se vetëm miratimi i këtij ligji do të mund ta prolongonte keqmenaxhimin e parasë publike në çdo institucion, në veçanti nga anëtarët e bordeve të ndërmarrjeve publike. Sipas tij, duhet të ndërpriten shtesat për të gjitha bordet e kompanive publike. Deputeti i LDK-së ka kritikuar partitë në pushtet për mosmiratimin e Ligjit për pagat. Abdixhiku ka thënë se detyra e parë e një qeverie serioze do të duhej të ishte kursimi i parasë, që pastaj ky kursim i parasë të finançohej në shëndetësi, arsim dhe gjyqësi

në keqpërdorimin ose keqshfrytëzimin që i bëhet parasë publike, në paga, mëditje, kosto shtesë, udhëtime zyrtare, dreka, darka, e kështu me radhë. Besoj se ka hapësirë për kursime. Unë kam prezantuar dhe idenë e shkurtimeve të mëditjeve, sepse është e paarsyeshme që një vizitë zyrtare në Shqipëri të paguhet 250 euro, sa është paga mesatare në Kosovë. Po ashtu, kam prezantuar edhe shkurtimeve të shtesave që i marrin institucionet e pavarura në vazhdimësi për punët e tyre që i bëjnë, sepse për punën që bëjnë ata do të duhej të paguheshin vetëm prej pagave dhe të mos kenë asnjë shtesë tjetër. Fatkeqësisht, një program i tillë i kursimeve s'ka gjetur mbështetje në qeverisjen e

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

Prishtinë, 11 shkurt - Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, e ka vlerësuar domosdoshmëri miratimin sa më të shpejtë të Ligjit për nivelizimin e pagave. Ai ka thënë se në mungesë të këtij ligji anë-

tarët e bordeve të ndërmarrjeve publike në Kosovë po vazhdojnë të marrin shtesa mbi pagë të paarsyeshme.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", deputeti i LDK-së ka pohuar se miratimi i Ligjit për pagat do ta pengonte keqpërdorimin e shumë mjeteve financiare. "Pa një ligj të tillë do të jetë e pamundur të korrigjohen të gjitha defektet. Ne si komision po mundohemi

aty ku kemi dorë të mbikëqyrjes të institucioneve dhe agjencive të pavarura ta bëjmë rolin tonë, pra t'i ndërpresim shtesat e caktuara", ka thënë Abdixhiku. Për mosmiratimin e këtij ligji ai ka fajësuar partitë në pushtet. Sipas Abdixhikut, këto parti politike këtë neglizhencë janë duke e bërë për interesa të ngushta partiake. "Unë po besoj se ka interesa të mëdha të partive në pushtet për t'i mbaj-

tur militantët partiakë", ka thënë Abdixhiku.

"Epoka e re": Z. Abdixhiku, ju keni qenë propozues i një fondi të kursimit të buxhetit duke shkurtuar mëditjet. Na thoni se si e keni paraparë?

Abdixhiku: Çdoherë kam prezantuar idenë e një plani të kursimit, por fillimisht besoj se buxheti i Kosovës ka hapësirë për kursime të mëdha, sidomos

ratohet sa më shpejt



"Epoka e re": *Mosmiratimi i Ligjit për nivelizim e pagave po krijon rrugë për keqpërdorim dhe keqmenaxhim të parasë publike?*

Abdixhiku: Shumë. Në fakt, pa një ligj të tillë do të jetë e pamundur të korrigjohen të gjitha defektet. Ne si komision po mundohemi aty ku kemi dorë të mbikëqyrjes të institucioneve dhe agjencive të pavarura ta bëjmë rolin tonë. Pra, t'i ndërpresim shtesat e caktuara. Kultura e kompensimit e krijuar deri më tani në institucionet tona që, pos pagës, bordet për të pasur edhe shtesa mbi pagë dhe mëditje për punën e tyre, nuk është në rregull. Po ashtu, dikush bën edhe siguracion të punës, pra i jep vetes shtesë për punën që e bën duke u thirrur në pasigurinë, e kështu me radhë. Dikush tjetër zbulon shtesa tjera që e rrisin në mënyrë artificiale pagën e marrë. Kjo nuk është praktikë e mirë. Andaj, ne si komision jemi duke i ndërprerë të gjitha këto praktika, siç kemi bërë edhe me rastin e anëtarëve të bordit të KOSTT-it. Por, për t'u zgjidhur kjo çështje në nivel nacional të Kosovës duhet të bëhet Ligji për nivelizim e pagave. Në këtë ligj do të duhej të bëhej edhe shkurtime i këtyre shtesave, edhe nivelizimi i pagave, pasi ka diskrepancë. Ne shpesh i mirëkuptojmë edhe agjencitë. Për shembull, ka agjenci ku bëhet punë shumë më shumë, por ka agjenci ku bëhet shumë pak punë. Prandaj, ligji për pagat është domosdoshmëri që duhet të bëhet. Ky ligj është një proces reformativ, por edhe i dhimbshëm për shumë kë.

"Epoka e re": *Pse po pronolgohet ky ligj?*

Abdixhiku: Besoj se ka interesa të mëdha të partive në pushtet për t'i mbajtur militantët partiakë. Është logjikë e njëjtë sikurse numri i zëvendësminis-

trave. Qeveria zgjerohet me zëvendësministra duke arritur numrin në 70 apo 80 sosh. Pra, kemi një Qeveri që ka shumë ministra dhe ka shumë njerëz për të akomoduar. Qëllimi është akomodimi i njerëzve në këto agjenci. Partitë politike, që ta bëjnë reformën eventuale, duhet t'i ndërpresin këto përfitime, sepse kjo është rruga e vetme për ta shpëtuar buxhetin e shtetit.

"Epoka e re": *LDK-ja çfarë ka në plan të bëjë si grup parlamentar në këtë drejtim?*

Abdixhiku: Ne veçse kemi filluar me punën tonë brenda komisionit. Kemi bërë rimodelimin e pagave të Trustit Pensional të Kosovës. Po ashtu, e bëmë edhe shkurtesën e shtesave të KOSTT-it dhe për secilin raportim që na vjen në komision do t'i bëjmë ndërprerjet e përfitimeve konform ligjeve. Si grup parlamentar kemi parashtruar kërkesë që të bëhet programi i kursimeve në buxhet. Mos të harrojmë se ne jemi opozitë dhe, fatmirësisht, ishim subjekti më aktiv në zvogëlimin e numrit të zëvendësministrave. Fatkeqësisht, propozimet tona s'po merren parasysh nga roli i opozitës. Do të duhej që LDK-ja të jetë në pozitë për t'i bërë ndryshimet eventuale, por në funksionin e tanishëm që jemi si komision po bëjmë shkurtime aty ku po mundemi në bazë të rolit opozitar që kemi.

"Epoka e re": *Pra, ju do ta vazhdoni këtë ritëm për ndërprerje të shtesave me të gjitha ndërmarrjet publike?*

Abdixhiku: Po. Çdo ndërmarrje publike që vjen në komisionin tonë do të marrë trajtim të njëjtë dhe të barabartë. Të gjitha shtesat që janë dhënë përtej pagës do të eliminohen. Ju e patë rastin e KOSTT-it. Njëjtë do të veprojmë edhe me të tjerët. Kur ka vullnet ka edhe zgjidhje. Ne do ta bëjmë

një gjë të tillë pasi konsiderojmë se ka nevojë që paratë e tyre dhe shtesat përtej pagës, të përdoren për arsim, shëndetësi dhe gjyqësi. Ne kemi paga që kapin shifrën 1 400 euro. Një pagë e tillë është shumë e lartë për një anëtar bordi dhe mbi këtë pagë vendosën shtesa për takime. S'ka logjikë të ketë pagë të lartë dhe të ketë shtesa. Këtu është vetëm një zgjidhje: ose duhet të merret paga ose shuma për pjesëmarrje në mbledhje.

"Epoka e re": *Institucionet financiare ndërkombëtare kanë dhënë shifra optimiste për rritjen ekonomike në Kosovë. Cili është mendimi juaj për këtë?*

Abdixhiku: Rritja ekonomike përcaktohet nga faktorët e tjerë. Normalisht se shpenzimet qeveritare janë një, por besoj se ambienti investiv në Kosovë e përcakton më së shumti ritmin e rritjes ekonomike. Natyrisht, rrjedhat e fundit kanë sjellë pasiguri në Kosovë dhe nuk do t'i kontribuojnë rritjes ekonomike të vendit. Tash varet sa do të jetë niveli i investimeve në vend, çfarë do të jenë investitorët e jashtëm për të kuptuar sa do të jetë rritja ekonomike. Ne kemi thënë, edhe në diskutimet tona parlamentare, se vazhdimi i politikës së investimit në asfalt nuk sjellë rritje të nevojshme ekonomike. Rritja e nevojshme ekonomike për Kosovën është 8 deri në 10 për qind, që pastaj të fillojmë të akomodojmë dhe t'i punësojmë të rinjtë të cilët janë të papunë. Për ta bërë një gjë të tillë do të duhej të investonim më tepër në arsim, gjyqësi dhe në ambient biznesor, kurse më pak në projekte të rrugës që na i marrin nga 12 apo 13 milionë euro për kilometër. Kuptohet se rrugët janë të nevojshme, por nuk ka logjikë që buxheti të shkojë veç në asfalt dhe t'i lëmë sektorët e tjerë pa investime. Me një politikë të tillë është e

pamundur të ketë rritje ekonomike prej 8 përqindësh çfarë neve na duhet.

"Epoka e re": *Sa para do t'i kushtojë Kosovës numri enorm i zëvendësministrave?*

Abdixhiku: Numri i zëvendësministrave në Kosovë, me gjithë ekipet përcjellëse, do t'i kushtojë Kosovës diku rreth 3 milionë euro në vit. Pra, këto janë para shtesë që kanë mundur lehtë të kursehen, por nuk janë vetëm këto para të vetme që janë keqpërdorur. Ne kemi thirrur interpellancë edhe për keqpërdorimet e tjera. 53 milionë euro u janë falur ambalazhuesve të ujit me një vendim qeveritar që është jokushtetues. Vendimet e faljes së borxheve dhe taksave bëhen nga parlamenti dhe nga Qeveria. Kemi rastin edhe për 60 milionë euro ndaj "Bechtel Enka"-s që janë të paarsyeshme. Prandaj, këtu shihet se ka një shturje të sistemit financiar në Kosovë dhe dhënies së parave gjithandaj, pastaj dëmet ekonomike janë me miliona, pa hyrë në dëmet e tjera që vijnë në mënyrë indirekte nga politikat jo të përgjegjshme, siç është akrobacioni politik me Gjykatën Special ose mosliberalizimi i vizave. Që të gjitha këto ndikojnë në ekonomi në fund të ditës.

"Epoka e re": *Do të duhej të kishim një "Task Force" qeveritare lidhur me këto dënime?*

Abdixhiku: Besoj se këto penalitë u takojnë ministrave përkatëse, institucioneve që i ka Kosova. Është bërë praktikë e zakonshme ku pazaret e tilla bëhen të qëllimshme në mënyrë që të dështojnë dhe më pas të kompensohen palët. Pra, është afër tipike korruptive që ka ndodhur edhe në shumë vende në tranzicion. Kjo është çështje e prokurorisë ta hetojë mënyrën se si arrihet te këto dëme dhe më pas të mbahen përgjegjës njerëzit që shkaktojnë dëmet.

Presidenti sloven vjen për vizitë shtetërore në Kosovë

PRISHTINË, 11 SHKURT - Presidenti i Republikës së Sllovenisë, Borut Pahor, do ta vizitojë sot (e hënë) Kosovën. Ai do të pritët nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Zyra për media e Presidencës ka bërë publike edhe

agjendën e dy presidentëve. "Në orën 15:00 për presidentin sloven do të ketë pritje ceremoniale në Sheshin 'Ibrahim Rugova', ku më pas do të mbahet edhe takimi i përbashkët i të dy delegacioneve, ndërsa në orën

16:10 dy presidentët do të deklarohen para medieve", është bërë me dije në njoftimin e Presidencës. Vizita e presidentit sloven realizohet në prag të 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës.



Kuvendi i pafuqishëm përballë Qeverisë

Artan Murati nga Instituti Demokratik i Kosovës ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se nga monitorimet e bëra, shihet se nuk ka një seriozitet të duhur nga ana e deputetëve për ta monitoruar zbatimin e ligjeve nga ana e Qeverisë. "Është një avaz i vjetër që po vazhdon edhe në këtë legjislaturë. Pra, deputetët do të duhej të ishin shumë më aktivë në monitorimin e zbatimit të ligjeve. Madje, edhe monitorimi kur bëhet, duhet të bëhet në mënyrë të mirëfilltë, sepse ka pasur raste ku deputetët janë dakorduar të shkojnë ta bëjnë monitorimin e zbatimit të një ligji, por paraprakisht e kanë informuar një institucion ose kudo ku kanë shkuar të monitorojnë.

PRISHTINË, 11 SHKURT - Kontrolli i dobët që ka Kuvendi i Kosovës ndaj punës së Qeverisë besohet se po ndikon në nivelin e ulët të zbatimit të ligjeve. Moszbatimi i ligjeve mbetet një nga çështjet kryesore që sfidon institucionet e vendit. Organizatat joqeveritare që monitorojnë punën e Kuvendit të Kosovës kanë vlerësuar deputetët e legjislaturës së gjashtë, sikurse dhe ata nga legjislaturat e kaluara, se nuk po arrijnë ta monitorojnë punën e Qeverisë për zbatimin e ligjeve.

Artan Murati nga Instituti Demokratik i Kosovës ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se nga monitorimet e bëra, shihet se nuk ka një seriozitet të duhur nga ana e deputetëve për ta monitoruar zbatimin e ligjeve nga ana e Qeverisë. "Është një avaz i vjetër që po vazhdon edhe në këtë legjislaturë. Pra, deputetët do të duhej të ishin shumë më aktivë

në monitorimin e zbatimit të ligjeve. Madje, edhe monitorimi kur bëhet, duhet të bëhet në mënyrë të mirëfilltë, sepse ka pasur raste ku deputetët janë dakorduar të shkojnë ta bëjnë monitorimin e zbatimit të një ligji, por paraprakisht e kanë informuar një institucion ose kudo ku kanë shkuar të monitorojnë. Në këto raste, edhe nëse ka pasur probleme për zbatimin e atij ligji, ato janë evituar të paktën për një kohë të shkurtër", ka thënë Murati.

Ai ka theksuar se komisionet parlamentare në Kuvendin e Kosovës, në planin e punës së tyre, shihet se kanë paraparë ta monitorojnë zbatimin e disa ligjeve, por se a do të ndodhë diçka e tillë, siç ka thënë ai, mbetet të shihet. "Zakonisht, një numër i vogël i ligjeve monitorohen nga ana e Kuvendit. Zakonisht komisionet i monitorojnë deri në dy ligje, që është numër shumë i vogël në



krahasim me atë se çka do të duhej të bënte Kuvendi", ka vlerësuar Murati.

Kryetarja e Komisionit për legjislacion në Kuvendin e Kosovës, Albulena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje, konsideron se ka shumë ligje që nuk gjejnë zbatim në terren. Megjithatë, ajo ka deklaruar se një pjesë e tyre miratohen nga Kuvendi vetëm sa për të marrë pikë pozitive në sytë e ndërkombëtarëve.

Haxhiu ka vlerësuar se monitorimi i zbatimit të ligjeve në të shumtën e rasteve nuk është bërë, pasi që Qeveria ka shpërfillur deputetët dhe kërkesat e tyre. "Kjo shpesh nuk është kryer me përgjegjësi nga ana e Kuvendit, pikërisht për faktin se në të

shumtën e rasteve, përfshirë edhe Qeverinë aktuale, pra qeveritë në vazhdimësi, kanë qenë shpërfillëse karshi institucionit më të lartë ligjvënës". "Ne jemi në dijeni se Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë një sërë ligjesh, por që, fatkeqsisht, ato kanë mbetur të pazbatuara për shkak të papërgjegjësisë së institucioneve, për të cilat edhe nxirren ligjet", ka theksuar Haxhiu. Sipas saj, disa komisione kanë gatishmëri dhe vullnet për monitorimin e zbatimit të ligjeve, ndonëse beson se duhet të bëhet edhe më shumë. "Ka një gatishmëri të disa komisionet parlamentare, sidomos komisionet parlamentare që udhëhiqen nga opozita. Por, nuk jam e kënaqur për shkak se ka potencial më

shumë në mënyrë që Qeveria të vihet para përgjegjësisë dhe sigurisht ta ngremë zërin për moszbatimin e ligjeve, për shkak se ky është përnjëmend problem, sepse ne ligjet i bëjmë për nevojat e qytetarëve dhe jo sa për të mbetur në sirtarët e institucioneve dhe të pazbatueshme", është shprehur Haxhiu.

Në republikat parlamentare, kuvendet mbikëqyrin punën e Qeverisë për zbatimin e ligjeve. Parlamenti si organ shtetëror është bartës i funksioneve më të rëndësishme shtetërore dhe politike të një shteti. Një ndër funksionet me shumë rëndësi, të cilin e ushtron Kuvendi përveç funksionit legjislativ, është edhe ai kontrollues i ekzekutiv.

SBASHK-u paralajmëron grevë më 14 shkurt



PRISHTINË, 11 SHKURT - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK), në një mbledhje të jashtëzakonshme ka diskutuar për moszbatimin e marrëveshjes së mirëkuptimit, që më 5 qershor 2017 e ka nënshkruar me koalicionin PDK-AAK-Nisma.

Ky koalicion që tash është në qeverisje, sipas marrëveshjes, është caktuar që brenda vitit 2017 të procedohet në Kuvend projektligji i hartuar nga

MASHT-i lidhur me statusin e punëtorëve të arsimit për vitet e '90.

SBASHK-u në këtë mbledhje ka marrë vendim që më 14 shkurt ta mbajë grevë orën e parë nëpër shkollat, si të ndërrimit paradiete ashtu edhe pasdite dhe, në rast se Qeveria nuk reflekton për këtë ligj, atëherë më 20 shkurt do të mbahet sërish grevë në dy orët e para të dy ndërrimeve. Nënshkruer të kësaj marrëveshjeje kanë qenë edhe Ramush Haradinaj dhe Kadri Veseli.



Donika Gërvalla largohet nga LDK-ja

PRISHTINË, 11 SHKURT - Aktivistja shumëvjeçare e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Donika Gërvalla, është larguar nga kjo parti. Ajo në llogarinë e vet në

"Facebook" ka shkruar se në LDK tashmë është e pamundur të punosh me nder dhe dinjitet për përparimin e Kosovës. "Shpresa e fundit ka vdekur. Kush beson në

ndryshime në këtë LDK, rrezikon ta mashtrojë vetveten", ka shkruar ajo. Donika Gërvalla është vajza e veprimtarit të çështjes kombëtare, Jusuf Gërvalla.

Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur mbledhjen e 32 të Këshillit të Përgjithshëm

Kurti: Jemi opozitë e fuqishme, e vëmë në vështirësi cilëndo qeveri

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka vlerësuar se ardhja në qeverisje e kësaj lëvizje tashmë është bërë domosdoshmëri. Ai ka theksuar se lëvizja që drejton është opozitë e fuqishme sa të mund ta vë në vështirësi cilëndo qeveri, në nivel qendror apo lokal. Kurti ka bërë me dije se Vetëvendosja edhe më tutje do të angazhohet për plotësimin e sovranitetit të Kosovës dhe për bashkimin me Shqipërinë

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 SHKURT - Lëvizja Vetëvendosje të dielën ka mbajtur mbledhjen e 32-të të Këshillit të Përgjithshëm, në të cilën ka marrë pjesë edhe kryetari i kësaj partie, Albin Kurti. Ai ka kërkuar nga delegatët e këtij këshilli, që të punojnë fuqishëm pasi, sipas tij, 19 vjet pas çlirimit të vendit, detyra e kësaj lëvizje është vendosja e Kosovës në binarë të zhvillimit dhe të forcimit.

Ai ka thënë se hapi i radhës është ardhja në qeverisje e Lëvizjes Vetëvendosjes, gjë e cila, sipas Kurtit, tashmë është domosdoshmëri. "Detyrë jona, 19 vjet pas çlirimit të Kosovës, është që ta vendosim Kosovën në binarët e zhvillimit dhe të forcimit, e për këtë është e nevojshme të qeverisim Vetëvendosja. Gjatë vitit 2017 ne i patëm disa fitore të shkëlqyera elektorale, u bëmë forca e parë në zgjedhjet qendrore dhe fituam dy qytetet më të mëdha, Prishtinën e Prizrenin, po ashtu fituam edhe Dardanën, si dhe arritëm në balotazh në Gjilan, Kaçanik e Besianë. Edhe në tri komuna të tjera Lëvizja jonë është në bashkëqeverisje: Mitrovicë, Vushtrri dhe Klinë. Hapi i radhës për ne është ardhja në qeverisje e Lëvizjes Vetëvendosjes, gjë e cila tashmë është edhe domosdoshmëri, duke pasur parasysh zhgënjimin e madh dhe pesimizmin që e kanë shkaktuar dështimet e njëpasnjëshme të subjekteve të tjera", ka deklaruar Kurti.

Ai ka vlerësuar se shtimi i aktivitetit opozitar, ndalja e projektligjeve të dëmshme në Kuvend, por edhe iniciativat ligjore me rëndësi për qytetarët e për grupe të ndryshme të intere-

sit, do të jenë detyrë mbi detyrat për grupin parlamentar të Vetëvendosjes dhe për organizatën në tërësi. "Jemi një opozitë aq e fuqishme, sa të mund ta vëmë në vështirësi cilëndo qeveri, në nivel qendror apo lokal, dhe do ta bëjmë këtë sa herë që të jetë e nevojshme në të mirë të interesit publik në Kosovë. Por do të jemi konstruktivë sa herë që pushteti të ndërmarrë hapa me interes për vendin e për popullin tonë. Një nivel i ri organizativ kërkon një rregullsi e disiplinë të shtuar, dhe mesazhi im për të gjithë aktivistët, duke përfshirë edhe deputetët, e ka formën e një kërkesë. Duhet të jemi të palodhur që t'u përgjigjemi nevojave të qytetarit, duhet të jemi të kujdesshëm, që të mos e zhgënjim asnjërin prej atyre që na ka votuar me plot shpresë. Duhet të jemi të hapur, të pranojmë kritika e diskutime me të gjithë ata që kërkojnë të diskutojnë me ne, dhe duhet të jemi të vendosur kundër të gjithë atyre që përpiqen të dëmtojnë të ardhmen e Kosovës dhe aspiratën tonë shoqërore e kombëtare", është shprehur Kurti.

Ai ka bërë me dije se Vetëvendosja edhe më tutje do të angazhohet për plotësimin e sovranitetit të Kosovës dhe për bashkimin me Shqipërinë si projekt vetëvendosës, zhvillimor e paqësor. "Ne i kemi themelet tona politike, ato të cilat na bëjnë të gjithëve bashkë, e me të cilat pajtohemi të gjithë. Ato janë: përpjekja e pandërprerë për plotësimin e sovranitetit të Kosovës dhe për bashkimin me Shqipërinë, si projekt vetëvendosës, zhvillimor e paqësor; rruga socialdemokratike për mbrojtjen dhe nxitjen e prodhimit vendor, zhvillimit ekonomik e punësimin, me



drejtësi sociale dhe jo vetëm gjyqësore; si dhe për forcimin e shtetit në mënyrë demokratike e të drejtë, ndryshe nga ç'kanë bërë pushtetet e deritanishme që e kanë mbrojtur korrupsionin e vet me autoritarizëm e me brutalitet", ka theksuar Kurti.

Ai ka treguar se rritja dhe zgjerimi i organizatës, emancipimi dhe ngritja e aktivistëve, lufta ndaj diskriminimit, forcimi i qendrave, rritja e bashkëpunimit me sindikata, shoqëri civile e medie si dhe promovimi i figurave me aftësi profesionale e politike, do

të jenë prioritet për Lëvizjen Vetëvendosje.

Në këtë kontekst, Kurti ka paralajmëruar se nga muaji mars e deri në muajin korrik do të organizohen zgjedhjet e strukturave të brendshme të Lëvizjes Vetëvendosje në qendrat ku ato nuk janë të kompletuara. "Muajt shkurt, mars dhe prill është mirë t'i shpallim muajt të anëtarësimeve të reja në Lëvizjen Vetëvendosje dhe muajt të pagesës së anëtarësisë nga anëtarët e Lëvizjes. Prej marsit e deri në korrik t'i organizojmë zgjed-

hjet e strukturave të brendshme të Lëvizjes Vetëvendosje në qendrat ku ato nuk janë të kompletuara. Dhe, të vizitohen qendrat nga kryetari, koordinatori i qendrave, sekretari organizativ, anëtarët e kryesisë dhe deputetët, për takime pune, sidomos për çështjet organizative. Në mbledhjet e përbashkëta me qendrat vijnë në shprehje të përbashkëta që kanë degët tona. Në mbledhjet me ato veç e veç trajtojmë edhe veçantitë e qendrave për gjendjen dhe nivelin e tyre të zhvillimit", ka theksuar Kurti.



Kusari-Lila zgjedhet kryetare e Alternativës, nënkryetar Ilir Deda

PRISHTINË, 11 SHKURT - Mimoza Kusari-Lila është zgjedhur kryetare e Alternativës. Ajo ka marrë 100 vota të delegatëve në Kuvendin e Parë Zgjedhor të këtij

subjekti politik. Në këtë kuvend zgjedhor të Alternativës janë zgjedhur edhe 51 delegatë të Këshillit të Përgjithshëm të kësaj partie, të cilët më pas zgjedhën

edhe Kryesinë, e cila përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarëve, prej tyre nënkryetar i parë u zgjodh Ilir Deda dhe nënkryetar i dytë Reshat Nurboja.

Në Arizona taksat do të mund të paguhen me Bitcoin

PRISHTINË, 11 SHKURT - Monedhat digjitale deri më tani janë përdorur në disa vende për të blerë bileta avioni, mobilie, muzikë, madje edhe pica. Por, shumë shpejt mund t'i paguani edhe taksat me to.

Të paktën kështu do të vendosin ligjvënësit në Arizona, ShBA. Një vendim ky që do ta revolucionarizojë mënyrën se si shteti i koncepton dhe ndërvepron me kriptomonedhat. Sipas raportimeve, një projektligj që pritet të miratohet do t'ua njohë Bitcoinit dhe kriptomonedhave të tjera statusin e kartmonedhës, duke mos i quajtur më produkt.

Ndërsa një ligj i dytë pritet të bëjë të mundur që të gjithë taksapaguesit në Arizona të shlyejnë detyrimet ndaj shtetit me

Bitcoin. "Mesazhi që duam t'u dërgojmë shteteve të tjera brenda ShBA-ve dhe në të gjithë botën është se Arizona është vendi i duhur për teknologjinë e parave elektronike", ka thënë përfaqësuesi i Kongresit të Shtetit të Arizonas, Jeff Weninger. Sipas tij, ky ligj do ta bënte më të lehtë pagimin e taksave për njerëzit.

Një studim i Universitetit "Cambridge" tregoi se në botë sot ka rreth 5,8 milionë llogari unike të kriptomonedhave.

Në vitin 2010, çmimi për një Bitcoin ishte vetëm 6 centë, ndërsa sot vlerësohet me 9 300 dollarë amerikanë. Majën e arriti më 16 dhjetor të vitit të kaluar, duke u vlerësuar me mbi 19 dollarë amerikanë.



TAP-i rrit investimet në Shqipëri, ngrihen qendra të mëdha magazinimi



TIRANË, 11 SHKURT - Konsorciumi që po ndërton gazsjellësin TAP ka miratuar një numër investimesh të reja shtesë në Shqipëri, ka raportuar "AzerNews". Sipas kësaj faqeje, TAP-i ka vendosur të ndërtojë

edhe një numër qendrash kompresimi, të cilat do të shërbejnë si qendra të mëdha magazinimi të gazit të Detit Kaspik në vendin tonë. Këto qendra do ta rrisin ndjeshëm potencialin e Shqipërisë

për të importuar dhe eksportuar gaz, si dhe do ta lehtësojnë zhvillimin e projektit të gazifikimit të vendit në një të ardhme të afërt. Gazsjellësi TAP është një investim prej 5 miliardë eurosh, që do ta

transportojë gazin e Kaspikut në Bashkimin Evropian përmes territorit turk, grek dhe shqiptar. Sipas parashikimeve të Universitetit të Oksfordit, ai do të jetë në gjendje ta përshpejtojë rrit-

jen ekonomike të Shqipërisë me 1 për qind përgjatë 10 vjetëve që pasojnë me vënien në punë të gazsjellësit. Gjithashtu, TAP-i do të gjenerojë mijëra vende pune në Shqipëri.

Kodi telefonik +383 do t'i sjellë përfitime të mëdha ekonomike Kosovës

Agron Dida, ekspert për çështje të telekomunikacionit, ka bërë me dije se kodi shtetëror i Kosovës +383 do të sjellë përfitime të mëdha ekonomike dhe shërbime cilësore dhe më të lira për konsumatorët

PRISHTINË, 11 SHKURT - Përdoruesit e telefonave të mençur (smart-phones) kanë hasur që këto ditë, kodi shtetëror i Kosovës +383, ka filluar të zbatohet nga aplikacione të ndryshme. Në listën e kodeve të shteteve tani në aplikacionin "Viber", i cili shërben për telefonata dhe mesazhe përmes internetit, mund të gjendet edhe Kosova me kodin telefonik +383.

Zbatimi i këtij kodi nga teknologjia "online" po konsiderohet si hap i rëndësishëm drejt zbatimit të plotë të kodit telefonik +383, që pritet të funksionalizohet përfundimisht më 30 qershor të këtij viti.


Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Kreshnik Gashi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se shfrytëzimi nga aplikacionet i kodit shtetëror të telefonisë të Kosovës është duke u bërë në kuadër të zbatimit si dhe në kuadër të njohimit të opinionit ndërkombëtar për përdorim të kodit +383. "Është obligim të shfrytëzohet nga të gjithë operatorët në të gjithë botën pasi të kalojë faza e tranzicionit që parashihet deri në fund të qershorit të hyjë në funksion dhe të përdoret vetëm kodi +383. Shfrytëzimi i kodit nga aplika-

cionet ka filluar më herët, por së fundi është bërë nga aplikacioni 'Viber', për çfarë ARKEP ka qenë në kontakt me shërbimin e këtij aplikacioni për ta shpejtuar këtë proces", ka thënë Gashi.

Ndryshimet që kanë ndodhur kohët e fundit me aplikacionin në "Viber", sipas Gashit, pritet të ndodhin edhe me të gjitha aplikacionet e tjera. Sipas tij, deri më tani kjo është bërë me shumë aplikacione që shfrytëzohet në rrjetet sociale, qoftë aplikacione që shfrytëzohen nga aeroporte të ndryshme nëpër botë.

Kodi shtetëror telefonik, Kosovës i është ndarë në dhjetor të vitit 2016 nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve (ITU). Ky kod ishte rezultat i bisedimeve në Bruksel ndërmjet delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Agron Dida, ekspert për çështje të telekomunikacionit, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se duhet bërë përpjekje nga autoritetet kompetente që kodin shtetëror të njohin edhe shërbimet e tjera të komunikimit. "Tani jo vetëm operatori Vala dhe IPKO, por edhe shërbimet në internet si 'Viber' ka njohur kodin +383 dhe kjo është hap mjaft i rëndësishëm në fushën e telekomunikimeve. Të presim që



këtë ta bëjë edhe 'Google', ta njohë kodin pasi që është sistem i fuqishëm i telekomunikimeve ndërkombëtare", ka thënë Dida. Dida ka thënë se përdorimi i kodeve të huaja ndërkombëtare ka qenë një pengesë e madhe në fushën e telekomunikimeve. Kodi telefonik i Kosovës, sipas tij, do të sjellë përfitime të mëdha ekonomike dhe shërbime cilësore dhe më të lira për konsumatorët. "Përveç shpenzimeve ka qenë pengesë e madhe në çdo aspekt. Ne duhet të identifikoheshim me një numër të Monakos apo Sllovenisë, kështu që nuk mund të bëheshin as transaksione bankare.

Ka qenë një gjendje që ka rënduar edhe bizneset dhe sistemet në përgjithësi, si dhe zbatimin e projekteve të ndryshme me sisteme të fuqishme të komunikimit", ka deklaruar Dida.

Aktualisht në Kosovë operojnë tre operatorë të telefonisë mobile dhe fikse, të cilët shfrytëzojnë kode të huaja ndërkombëtare. Telefonja mobile "Vala" shfrytëzon kodin e Monakos (+377), ajo e IPKO-s kodin e Sllovenisë (+386), kurse telefonja fikse shfrytëzon kodin e Serbisë (+381).

Ndërkohë, sa i përket telefonisë fikse, thirrjet hyrëse dhe dalëse

vetëm se realizohen me kodin +383 dhe, sipas Kreshnik Gashit, kodi +381 i Serbisë mund të largohet para muajit qershor. "Kodi +381 është duke u shfrytëzuar vetëm për shkak të moshumbjes së ndonjë thirrje eventuale, e që pritet të ndërpritet më së largu deri më 30 qershor. Por, sipas informatave që kemi nga operatorët telefonikë, kjo mund të ndodhë edhe më herët, pasi në masë të plotë është duke u shfrytëzuar vetëm +383 për thirrjet hyrëse dhe dalëse", ka thënë Gashi. Kostot e përgjithshme të shkaktara deri më tani nga mungesa e kodit telefonik kanë arritur shifrën në mbi 200 milionë euro.

Përfaqësuesit e BQK-së njoftohen nga afër rreth pagesave me kartela në Stamboll



PRISHTINË, 11 SHKURT - Në funksion të shkëmbimit të përvojave dhe njohjes me zhvillimet e reja në fushën e shërbimeve të pagesave, zëvendësguvernatori për Operacione Bankare në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), Lulzim Ismajli dhe drejtori i sistemit të pagesave, Dardan Fusha, kanë vizituar institucionin për procesimin e pagesave me kartela 'Bankalararasi Kart Merkezi' (BKM) në Stamboll, të themeluar nga sektori bankar në Turqi, i cilin jithet si një shembull i suksesshëm i iniciativës së bankave për lehtësimin e pagesave me anë të kartelave dhe krijimin e infrastrukturës moderne për ndërveprimin e operatorëve që ofrojnë shërbimet e pagesave në Turqi. Delegacioni i BQK-së u takua me kryesuesin e BKM-së, Soner

Canko, zëvendëskryesuesit Cenik Temz dhe Pelin Guven.

Gjatë kësaj vizite u diskutua për zhvillimet e fundit në fushën e pagesave dhe modelin e adaptuar nga sektori bankar në Turqi për shfrytëzimin e teknologjive të reja në rritjen e përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike.

Përfaqësuesit e BKM-së shprehën gatishmërinë për ofrimin e njohurive dhe përvojave për BQK-në lidhur me adaptimin e një zgjidhje të ngjashme për procesimin e pagesave me kartela në Kosovë. Në përfundim të takimit përfaqësuesit e dy institucioneve u pajtuan ta vazhdojnë bashkëpunimin dhe takimin e radhës ta mbajnë në BQK në një të ardhme të afërt.

Rasti i Oliver Ivanoviqit, prokuroria kërkon paraburgim për policët

MITROVICË, 11 SHKURT - Prokuroria e Mitrovicës ka paralajmëruar se do të dorëzojë në gjykatë kërkesën për paraburgim për dy policët e arrestuar të shtunën si të dyshuar për keqpërdorim të provave në rastin e Oliver Ivanoviqit.

Prokurori Njazi Rexha ka thënë për "Kallxo.com" se kërkesa do të dorëzohet të dielën, ndërsa nuk ka dhënë detaje të tjera për rrjedhën e hetimit të deritanishëm.

Dy policët e Kosovës, D. M. (1970) dhe Zh. M. (1970), u arrestuan të shtunën nën dyshimin se nuk ishin kujdesur për ruajtjen me kujdes të vendit të ngjarjes pak minuta pas vrasjes së Oliver Ivanoviqit.

Prokurori Njazi Rexha, i cili po heton rastin, ka konfirmuar se arrestimi i dy policëve ndërlidhet me mënyrën se si është ruajtur vendi i ngjarjes pas incidentit. "Ata kanë qenë në detyrë ta ruajnë vendin e ngjarjes dhe nuk e kanë kryer detyrën e tyre siç duhet", ka thënë Rexha.

Ai ka sqaruar se janë duke hetuar pasojat e veprimeve të policëve.

Lajmin për arrestimet e dy zyrtarëve policorë të Stacionit në Mitrovicën Veriore e ka bërë me dije Inspektorati Policor. Sipas komunikatës së Inspektoratit, këta zyrtarë u arrestuan nën dyshimin për manipulim të provave.

Inspektorati njoftoi se, përveç arrestimeve, ka bastisur dy lokacione në Mitrovicën Veriore me urdhër të prokurorit dhe gjykatës. "Hetuesit e IPK-së dhe PK-së kanë zbatuar urdhëresën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë dhe janë bastisur dy lokacione në Mitrovicën e Veriut. Gjatë bastisjeve është konfiskuar një revole e llojit TT si dhe dy karikatorë me nga 9 fishekë të kalibrit 7.62 mm që do të shërbejnë për procedurën penale të mëtutjeshme", thuhet në komunikatën e Inspektoratit Policor.

Të arrestuarve u është caktuar ndalimi policor prej 48 orësh.



Politikani i serbëve të Kosovës dhe kryetari i Nismës Qytetare "Liri, Demokraci, Drejtësi", Oliver Ivanoviq, u vra në Mitrovicën Veriore më 16 janar. Ai u varros një ditë më pas në Beograd.

Vrasja e tij është dënuar gjerësisht nga zyrtarët e BE-së, ata

serbë dhe zyrtarë të institucioneve të Kosovës. Ai shihej si një politikan i moderuar në Kosovë që përkrahte bashkëjetesën midis pakicës serbe dhe shqiptare. Megjithatë, Ivanoviqi po rigjykohej për urdhërimin e vrasjes së shqiptarëve të

Kosovës në vitin 1999, gjatë luftës së Kosovës për pavarësi. Ai e kishte deklaruar veten të pafajshëm. Serbia ka kërkuar përfshirje në hetimin për vrasjen e Ivanoviqit, ndërsa dy shtetet në mënyrë të tërthortë janë duke shkëmbyer informata për këtë vrasje.



Haziri paralajmëron plan masiv të investimeve në Gjilan

GJILAN, 11 SHKURT - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se gjatë viteve 2018-2021 pritet të realizohet plani masiv i investimeve në këtë komunë, në të gjitha fushat, përdërisa ka ripërsëritur se pas dy vjetëve të para të mandatit të ri do të ndodhë tregimi i madh. "Duhet të angazhohemi në qeverisje mbi

partiake, në shërbim të qytetarëve. Riorganizimi do të ndodhë edhe në shërbim civil në funksion të realizimit të planeve dhe riorganizimit të detyrave, sikur që do të ndodhë edhe riorganizimi i zyrave. Gjatë këtij muaji do të organizohet debat publik me qytetarët, shoqërinë civile e grupet e interesit për t'i përfshirë në pro-


cesin e vendimmarrjes", ka thënë Haziri. Sa iu përket investimeve në infrastrukturë, Haziri ka theksuar se janë nënshkruar kontratat në vlerë prej 2.9 milionë eurosh për ndërtim të rrugëve, kanalizim e ujësjellës në fshatra dhe qytet për vitin 2018, duke përmendur edhe vazhdimin dhe projekteve të mëdha.

I mituri vret të miturin me armë zjarri në Klinë

KLINË, 11 SHKURT - Një i mitur, i fshatit Grabanicë të Klinës, ka vdekur të dielën në mëngjes pasi u plagos aksidentalisht me armë zjarri. Një 13-vjeçar ka qëlluar aksidentalisht një 12-vjeçar me armë zjarri. 12-vjeçari i plagosur ka ndërruar jetë në Emergjencën e Qendrës

së Mjekësisë Familjare në Klinë.

Patrullat e policisë menjëherë kanë dalë në terren, ku më pas mjeku kujdestar ka deklaruar se i mituri është pa shenja jete. Prokurorja kujdestare në Pejë, Zahide Gashi, ka thënë se bëhet fjalë për një vrasje aksidentale.



Arrestohen pesë persona në Prishtinë për posedim të narkotikëve

PRISHTINË, 11 SHKURT - Pesë persona janë arrestuar në tri lokacione të ndara për posedim të narkotikëve në rajonin e Prishtinës, ndërsa janë

konfiskuar dhjetë qese me marijuanë. Me vendim të prokurorit katër nga të arrestuarit janë liruar në procedurë të rregullt, ndërsa

njëri është dërguar në mbajtje për shkak se, pas kontrollit në banesën e tij, janë gjetur edhe nëntë qese të tjera me marijuanë.

"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (3)

ADEM DEMAÇI NUK U TËRHOQ KURRË PËRBALLË ASNJË TRYSNIE



Selatin NOVOSELLA

31. Bajram Kosumi, kryeministër i Republikës së Kosovës: Adem Demaçi, kujdestari fanatik i lirisë. Për dyzet vjet Adem Demaçi e ushqeu lirinë. Ai qe kopshtari shpesh herë i vetëm i lirisë, kujdestari fanatik i lirisë. Kur të gjithë dyshuan të ëndrra e lirisë, ai foli për lirinë. Ai qëndroi me pishtarin e lirisë në duar edhe atëherë kur mund t'i dilte shpirti nga trupi.

32. Bamir Topi, president i Republikës së Shqipërisë: Adem Demaçi, hero i gjallë i Kosovës. Unë sot ndihem krenar që në emër të Shtetit shqiptar nderoj me dekoratën më të lartë "Nderi i Kombit" një emër qëndresë dhe disidence, një intelektual atdhetar të shquar, shkrimtarin dhe veprimtarin e të drejtave të njeriut "Mendelën e Kosovës" dhe heroin e gjallë të Kosovës Adem Demaçin. Miku im Adem, jemi me fat që ju kemi sot midis nesh.

33. Bardhyl Selimi: Adem Demaçi ishte për liri dhe barazi në hapësirat e Ballkanit. Adem Demaçi, dy ditë pas lirimit nga burgu i tretë, në vitin 1990, në intervistën e parë që ia dhe një televizionin sloven, pa shprehur kurrfarë urrejtje ose mllefi hakmarrës, ai u mundua të hapte rrugë e shtigje për gjetjen e zgjidhjeve të pranueshme dhe të favorshme për të gjithë ata që jo vetëm me fjalë por edhe me vepra ishin për liri dhe barazi në hapësirat e Ballkanit.

34. Baron Krespo, kryetar i Parlamentit Evropian: Çmimit "Saharov", Adem Demaçit iu dha me vota të fshehta Komisioni politik, në bazë të letrës së 8 nëntorit 1991, ia ka përcjellë propozimin Byrosë së zgjeruar, ku në mbledhjen e kësaj byroje më 21 nëntor 1991, ka vendosur me vota të fshehta, që Çmimit "Saharov" për vitin 1991 t'ia japin Adem Demaçit.

35. Basri Musmurati, sekretar i Partisë Demokratike të Kosovës: Adem Demaçi, njeriu më i veçantë i luftës për lirinë e Kosovës. Adem Demaçi, njeriu më i veçantë i luftës për lirinë e Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore, është gjithnjë i thjeshtë dhe i matur edhe pas lirimit të tij nga burgu i tretë në vitin 1990.

36. Bedri Selmani, afarist: Adem Demaçi nuk e pranoi paqen në robëri. Adem Demaçi është tribun

shpirtëror i Çështjes kombëtare i cili, në lutën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u bë simbol dhe përfaqësues ideologjik i kësaj ushtrie. Ai, ndër të parët nga ne, e kuptoi se nuk ka "paqe në robëri" dhe tërë këtë e arsyetoi duke vepruar në kauzën se të gjitha ato kombe që kanë pranuar "paqen në robëri", janë dy herë të robëruara, moralisht dhe ekonomikisht.

37. Bedri Zyberaj, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi nuk u tërhoq kurrë përballë asnjë trysnie

Adem Demaçi, si njeri që e karakterizon guximi, dashuria për njeriun dhe gadishmëria për vetëmohim, në asnjë kohë, përballë asnjë trysnie, ai nuk është tërhequr nga ajo që e mendonte se i përkiste. Andaj, pa Adem Demaçin, kombi ynë do ishte më i pakët, më i vogël dhe më i zbehtë në aspektin kulturor, filozofik, shpirtëror dhe politik.

38. Begzad Baliu, profesor i Universitetit të Prishtinës: Adem Demaçi, personalitet i veçantë. Adem Demaçi është i veçantë, së paku për tri arsye: e para, ai ishte i burgosur politik në ish-Jugosllavi, por jo disident i formatit të të burgosurve politikë të popujve të tjerë; e dyta, ai ishte veprimtar politik që drejtonte një organizatë ilegale të Lëvizjes çlirimtare; dhe, e treta, ai ishte njeriu kryengritës me prirje të veçanta letrare.

39. Behare Rexhepi, veprimtare e çështjes kombëtare: Adem Demaçi, sinonim i lirisë

Në tërë diasporën shqiptare, emri i Adem Demaçit ishte bërë sinonim i lirisë. Emri i Demaçit ishte bërë referencë kyçe për kërkesat e shqiptarëve që iu drejtoshin institucioneve botërore.

40. Behxhet Shala, kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë: Pak personalitete në botë janë si Adem Demaçi që fitoi çmime të rralla. Adem Demaçi është fitues i Çmimit "Saharov", "Doktor Honoris Causa", "Nderi i Kombit" dhe "Hero i Gjallë i Kosovës". Përmenda vetëm disa tituj që nuk fitohen lehtë dhe se ka pak personalitete në botë që i fitojnë këto nderime.

41. Bislim Elshani, redaktor i gazetës "Alternativa": Adem Demaçit të gjitha i nënshtrohen qëllimit kombëtar. Në veprimtarinë e Adem Demaçit gjithçka i nënshtrohet qëllimit të madh nacional: edhe Bibla e Kurani, edhe suret e hadiset e Pejgamberit, edhe kishat e xhamitë, edhe marksizmi i mëparshëm dhe antmarksizmi i mëvonshëm, edhe platonizmi e hegelizmi, edhe fizika dhe kimia kuantike, edhe orët e zanat e malit.

42. Bedri Islami, kryetar i Lëvizjes Popullore të Kosovës: Emri i Adem Demaçit ishte emër shprese. Shumë prej të burgosurve politikë që ishin, tashmë, në radhët

drejtuese të Lëvizjes Ilegale apo të strukturave drejtuese të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kishin qenë me vite shokë të burgut të Adem Demaçit. Ai e kishte ndarë atë copë qelie dhe dhimbjen e burgimit me Fehmi Lladrovcin, Xhavit Halitin, Azem Sylën, Sejdi Gegën, Hasan Ukëhaxhajn, Ali Ahmetin, Shaban Mujën etj. Me shumë prej tyre, ose më sakt, me të gjithë ata e kishte ruajtur miqësinë edhe pas daljes nga burgu, dhe ndoshta në vete e kishte ndjerë se koha e tyre kishte shkuar para kohës së tij. Megjithatë, vetë emir i Demaçit në fillimin e vitit 1998 ishte një emër shprese. Idealistët po shkonin drejt shpresës.

43. Bejtullah Tahiri, veprimtar i çështjes kombëtare: Vepra e Adem Demaçit është kapitale. Vepra e Bacës Adem Demaçi është kapitale. Ajo në vete ngërthen tërë flijimin e djalërisë dhe jetës së tij për një ideal të shenjtë lirie. Në historinë e lavdishme të Kosovës, nuk mund të gesh edhe një model si ai.

44. Beqir Musliu, shkrimtar: Adem Demaçi, në tabanin tonë kombëtar, e shkroi emrin shqiptar. Adem Demaçi personifikon emrin tim dhe tëndin, ai është Ne, i shumëzuar në mijëra, miliona dhe në bazament të tabanit tonë kombëtar e shkroi emrin tonë të madh, emrin shqiptar. Legjenda e gjallë ecë me këmbët e veta dhe futet në katakomb për të vdekur për qenien tonë shqiptare.

45. Berat Luzha, kryetar i Shoqatës së Burgosurve Politikë të Kosovës: Adem Demaçi, Drajtusi i Kosovës. Adem Demaçi është Mendela i Kosovës, Drajtusi i Kosovës dhe, njëkohësisht, Krishti i shqiptarëve, sepse edhe përkundër golgotës së tij, ai për "xhelatët" e tij do të thotë: "fali, o Zot, ata nuk kanë ditur se ç'kanë bërë!"

46. Besa Çeku, gazetar: Adem Demaçi, ndër personalitetet më të kulturuar në Kosovë. Adem Demaçi dhe të burgosurit politikë shqiptarë të Kosovës dhe Viseve shqiptare në ish-Jugosllavinë ishin, jo vetëm shtresa më vetëdijshme, më e guximshme dhe më sakrifkuese por, gjithsesi, edhe shtresa më e kulturuar e jona.

Kështu mund të thuhet për faktin se, është e njohur nga historia, vetëm popujt e kulturuar nuk pranojnë, me asnjë çmim, që të jetojnë nën robëri.

47. Besa Hoxha-Beqiri, profesore-shë: Adem Demaçi ka mbajtur gjallë shpresën e shqiptarëve për liri. Adem Demaçi dhe 34 atdhetarë tjerë janë dënuar në procesin politik të vitit 1975, sepse kanë menduar shqiptarisht, dhe me këtë kanë mohuar tendencën e Beogradit për jugosllavizimin e shqiptarëve; janë dënuar sepse në mendjet e tyre kanë projektuar lirinë, dhe me këtë kanë stigmatizuar lirinë e rrejtshme të pushtetit; janë dënuar sepse nuk kanë hequr dorë prej përcaktimeve të tyre politike-kombëtare dhe veprimtarive të tyre të mëherëshme në këtë drejtim, dhe me këtë kanë mbajtur të gjallë shpresën e shqiptarëve për liri.

48. Besim Zymberi, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi, misionar dhe filozof. Nëse Adem Demaçin e njohim si misionar, ai në të vërtetë ishte dhe mbetet: Mision i pëdurimit të vlerës së nocionit të lirisë. Nëse Demaçin e njohim dhe e vlerësojmë si filozof, ai në të vërtetë është: Filozofi e avancimit të botëkuptimit të lirisë, në përmasën dhe dimensionin e saj të mirëfilltë.

49. Besnik Mustafaj, shkrimtar: Adem Demaçi, i panshtuar i durueshëm. Nuk besoj se ka shqiptar që nuk vihet në mendime, kudo që të ndodhet në botë, kur sheh se Adem Demaçi ka marrë vendimin për t'u mbyllur në grevë urie. Jeta dhe vepra e tij dëshmojnë më së miri, tashmë, jo vetëm guximin e tij, jo vetëm përkushtimin e tij, por edhe maturinë e tij. Adem Demaçi ka qenë dhe është i panënshtuar i durueshëm.

50. Binak Ullaj, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi i toleronte dhe i afroste edhe ata që, dikur, veprimtarinë e tij e kishin quajtur "veprimtari armiqësor". Baca Adem Demaçi, si kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, përveç përpikërisë, shquhej edhe me ndjenjën e mirëkuptimit dhe tolerancës

dhe u afroste bashkëpunim edhe atyre të cilët dikur e kishin quajtur veprimtarinë e tij "veprimtari armiqësor", "veprimtari kundër interesave të popullit shqiptar"...!

51. Blerim Shala, publicist: Adem Demaçi kërkonte që negociatat Kosovë-Serbi të ndërmytësoheshin dhe të garantoheshin nga ShBA-të

Që të arrihej armëpushimi në mes forcave të UÇK-së dhe forcave serbe, sipas Adem Demaçit, nga Kosova duhej të bëhej tërheqja e plotë e të gjitha forcave ushtarake-police serbe, pastaj Tribunali i Hagës për Krime të Luftës duhej të fillonte hetimet në Kosovë, duhej t'i mundësohej refugjatëve kthimi në shtëpitë e tyre, duhej t'i paguhej dëmshpërblimi të gjitha familjeve të dëmtuara shqiptare në luftën e këtij viti, pastaj duhej të mundësohej funksionimi i të gjitha organizatave humanitare kombëtare dhe ndërkombëtare dhe, më në fund, negociatat duhej të garantoheshin nga ShBA-të.

52. Branko Horvat, ekonomist dhe kandidat për çmimin Nobel: Adem Demaçi kishte për qëllim ta fitonte të drejtën për vetëvendosje për viset e banuara me shqiptar në Jugosllavi

Shkrimtari Adem Demaçi, i cili në vitin 1963 themeloi organizatën "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", kishte për qëllim ta fitonte të drejtën për vetëvendosje deri në shkëputje për viset e banuara me shqiptarë në Jugosllavi. Është në burg, me ndërprerje, më tepër se 23 vite.

53. Bujar Dugolli, kryetar i Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës: Baca Adem Demaçi na tha studentëve: "Bravo, ju studentët, e keni dhënë provimin!"

Më 21 gusht 1997 e vizitua Adem Demaçin në selinë e Partisë Parlamentare të Kosovës, të cilën atyre ditëve e udhëhiqte Baca. Pritja ishte shumë e ngrohtë. Adem Demaçi na përgëzoi për vendimin tonë në Unionin e Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës për organizimin e Protestës së ardhshme të Një Tetorit 1997. Baca Adem na tha: "Ju si Union, si studentët e keni dhënë provimin. Bravo ju qoftë!"

54. Daniel Leuwers: Adem Demaçi, pasardhës i figurave eminente dhe të jashtëzakonshme si Nelson Mandela, Dupçeku dhe Hang Suu Ki

Adem Demaçi është bartës i një çështjeje të madhe kombëtare e që kishte përfunduar me pavarësinë e vendit të tij për çka kishte punuar dhe aq shumë e kishte dashur. Fati ka dashur që lufta e Adem Demaçit për t'i mbrojtur të drejtat më elementare të shqiptarëve të Kosovës që qëndrojë mbi 28 vite burg të rëndë. (Vijon)



Shtëpia e Bardhë: Izraeli ka të drejtë të vetëmbrohet

Në deklaratën e Shtëpisë së Bardhë të dielën thuhet se Amerika mbështet të drejtën e këtij vendit për t'u vetëmbrojtur nga forcat siriane dhe grupet parashtarake, të mbështetura nga Irani në Sirinë Jugore

WASHINGTON, 11 SHKURT - Një deklaratë nga zyra e shtypit e Shtëpisë së Bardhë të dielën konfirmoi se "Izraeli është një aleat i vendosur i Shteteve të Bashkuara". Në deklaratë thuhet se Amerika mbështet të drejtën e këtij vendit për t'u vetëmbrojtur nga forcat siriane dhe grupet parashtarake, të mbështetura nga Irani në Sirinë Jugore. Deklarata e Shtëpisë së Bardhë u bëri thirrje Iranit dhe aleatëve të tij t'i ndërpresin veprimet provokuese dhe të punojnë drejt paqes rajonale.

Deklarata vjen pas sulmit të Izraelit të shtunën kundër një duzinë objektivësh iranianë dhe sirianë në Siri.

Izraeli i kreu sulmet ajrore pasi një avion i tij ushtarak u rrëzua nga goditjet. Avioni po kthehej nga një operacion sulmues kundër pozicioneve të grupeve luftarake të mbështetura nga Irani në Siri. Më parë, Izraeli pati thënë se kishte rrëzuar një dron iranian të nisur nga Siria, pasi kishte hyrë në territorin izraelit në orët e vona të së premtes. "Unë fola një orë më parë me presidentin rus Vladimir Putin. I përsërita atij të drejtën dhe detyrën tonë për t'u vetëmbrojtur kundër sulmeve të drejtuara kundër nesh nga territori sirian. Kemi rënë dakord që koordinimi i sigurisë midis forcave tona ushtarake të vazhdojë. Bisedova edhe me sekretarin amerikan të Shtetit, Rex Tillerson, rreth zhvillimeve të fundit dhe zhvillimeve të tjera rajonale. Dua ta bëj të qartë: Izraeli kërkon paqen. Por ne do të vazhdojmë



të vetëmbrohemi me vendosmëri ndaj çdo sulmi kundër nesh, ndaj çdo përpjekjeje nga ana e Iranit për të depërtuar ushtarakisht në Siri apo në ndonjë vend tjetër", tha kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu.


Në sulmin e së shtunës, një avion izraelit F-16 u rrëzua nga Ushtria siriane.

Pilotët izraelitë ishin në gjendje të hidheshin me parashutë nga avionët e tyre,

thënë Forcat Izraelite të Mbrojtjes (IDF). Media shtetërore siriane njofton se Siria po i përgjigjet agresionit të ri izraelit, pas sulmit.

Zëdhënësi i Ushtrisë izraelite, gjeneralbrigade Ronen Manelis, tha se Irani po e tërheq rajonin në një situatë së cilës nuk i dihet fundi. Ne jemi të përgatitur për një sërë incidentesh dhe kushdo që është përgjegjës për këtë incident, ai që do ta paguajë çmimin.

LAJME SHKURT



Guterres kërkon ndaljen e menjëhershme të përshkallëzimit në Siri

NJU JORK, 11 SHKURT - Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, ka bërë thirrje për ndalje të menjëhershme të përshkallëzimit në Siri, pasi Izraeli ka ndërmarrë sulme ajrore brenda Sirisë, që është e shkatërruar nga lufta civile, e cila ka filluar në vitin 2011.

Zëdhënësi i Kombeve të Bashkuara, Stephane Dujarric, ka thënë se Guterres "po e ndjek për së afërmi përshkallëzimin alarmant ushtarak në Siri dhe për përhapje të rrezikshme përgjatë kufijve të vet".

Më tutje, Dujarric theksoi se Guterres është shprehur se të gjitha palët në Siri dhe rajon duhet ta respektojnë të drejtën ndërkombëtare në periudhën e shtimit të dhunës, përfshirë sulmet ajrore të Izraelit kundër pozicioneve të mbështetura iraniane dhe për ndërhyrjen e forcave turke në pjesën veriore të Sirisë. Ai tha se Guterres u ka bërë thirrje të gjithëve të punojnë për ndaljen e përshkallëzimit të menjëhershëm dhe pa kushte të dhunës dhe të tregojnë përmajtje.



Sulmohet agjencia e sigurisë afgane, të paktën 16 të vdekur

ISLAMABAD, 11 SHKURT - Zyrarët afganë thonë se katër operativë të agjencisë kombëtare të zbulimit qëlluan për vdekje 16 kolegë të tyre para se të largoheshin nga skena e ngjarjes për t'u bashkuar me kryengritësit talebanë në provincën Helmand. Sulmi u krye në një objekt që i përket Drejtorisë Kombëtare për Sigurinë në distriktin Gerishk, kanë njoftuar të dielën burime të strukturave të sigurisë.

Omar Zawak, zëdhënësi i qeverisë lokale, e konfirmoi incidentin duke thënë se Talebani kishte sulmuar qendrën e sigurisë nga jashtë, ndërsa në mjediset e brendshme po kryhej sulmi nga katër operativët, duke rezultuar në një betejë me armë zjarri mes ekstremistëve dhe rojeve të sigurisë. Zëdhënësi tha se ka pasur një numër të madh të vrarësh nga të dyja palët, por pa dhënë shifra konkrete.

Konfirmohet vdekja e 71 vetave nga rrëzimi i aeroplanit në Rusi

MOSKË, 11 SHKURT - Një aeroplan vendës i udhëtarëve në Rusi është përplasur pak kohë pasi është ngritur nga një aeroport i Moskës, me ç'rast janë vrarë të 71 personat që gjendeshin në të, thanë autoritetet e Ruisë. "65 udhëtarë dhe 6 anëtarë të ekuipazhit ishin në aeroplan dhe të gjithë ata kanë vdekur", ka njoftuar të dielën Zyra e Ruisë për hetime në transport.

Aeroplani i tipit Antonov An-148, i kompanisë Saratov Airlines, është zhdukur të dielën nga radarët, derisa ishte duke fluturuar nga aeroporti Domodedovo në Moskë për në Orsk të Uralit, ka raportuar agjencia "Interfax". "Aeroplani është përplasur afër fshatit Argunovo", afro 80 kilometra në juglindje të Moskës, ka raportuar "Interfax", duke e cituar një burim të shërbimeve të emergjencës.

Dmitry Peskov, zëdhënësi i presidentit të Ruisë, Vladimir Putin, tha se presidenti "u ka shprehur ngushëllime të thella atyre që i kanë humbur të afërmit në këtë përplasje".



Kanali televiziv shtetëror rus, "Rossiya-24", ka transmetuar pamje të copave të aeroplanit në një terren të mbuluar me borë, ndërsa në afërsi nuk janë parë ndërtesa.

Ministria e Situatave Emergjente e



Ruisë tha se janë gjetur trupat e pajetë dhe pjesë të mbetjeve në vendin e përplasjes.

Një prej regjistruarëve të fluturimit (kutia e zezë) është gjetur, kanë thënë zyrarët.

Shfletime historike: Personaliteti i Qazim Bajraktarit (1906-1947)

Në jubileun e rëndësishëm për popullin shqiptar të nderohen heronjtë

Përkimet vazhdojnë të jenë edhe më sublimë: 71 vjet më parë, më 17 shkurt 1947, vritet Qazim Bajraktari. Në dhjetëvjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në këtë jubile të rëndësishëm për popullin shqiptar, në përgjithësi nderohen heronjtë. Dhe vendin meritohet duhet zë edhe emri i Qazim Bajraktarit...

Enver S. MORINA

Në motet në të cilat vitet ecin më shpejt rilexojmë vargjet e poetit Din Mehmeti si një prolog për Ata:

"Askush nuk mund të matet me ju

Askush nuk gjendet më thellë se ju

Askush më lartë se ju

Ju shpuat tokën gjer kur merr frymë dashuria

Ju shpuat shkëmbinjtë gjer kur rritet qëndresa..."

Atdhetarizmi, veprimtaria dhe ideali i Qazim Bajraktarit (1906-1947) për një Shqipëri etnike

Krahina e Llapushës numëron rreth 56 fshatra, prej të cilëve shumica në kohën e Turqisë i takonin Bajrakut të Astrazupit. Kjo trevë përgjatë kohërave dhe sidomos në gjysmën e parë të shekullit XX ishte vendstrehim i luftëtarëve e atdhetarëve të njohur si Isa Boletini, Bajram Currit, Hasan Prishtinës, Azem

e Shote Galicës, Hasan Prishtinës, e të tjerëve. Qazim Bajraktari atdhedashur-inë e trashëgoi nga i ati Alushi (Lushi) dhe xhaxhai Abazi. Në vitin 1900 Alushi dhe Abazi i kishin mbledhur pjesëtarë të gjitha fshatrave të Bajrakut të Astrazupit në një tubim të madh në xhaminë e Banjës për ti pajtuar gjaqet dhe ngatërresat që mbretëronin në atë kohë dhe për tu përgatitur në luftë kundër Hyrjetit turk. E njohur si Lufta e Banjës nisi në vitin 1920 e udhëhequr nga Bajraku i Astrazupit në krye të së cilës



Qazim Bajraktari (1909-1947)

ishin Alushi (Lush) Bajraktari, Abaz Bajraktari dhe Asllan Laci. Veprimtaria e atdhetarit Qazim Bajraktarit fillon nga viti 1930 deri në vitin 1947.

Në vitin 1939 në drejtimin e Ilaz Agushit dhe Mit'hat Frashërit

formuan brigada vullnetare për mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë Etnike nga ekspansionistët serbo-çetnike. Prej brigadave formuan Qetën e Garaqevës e cila në fillim kishte 150 luftëtarë për të arritur deri në 1000 të cilët vinin nga të gjitha viset e Kosovës në përbërje më të madhe nga rrethina e Bajrakut të Astrazubit, që për komandant zgjodhën Qazim Bajraktarin i cili iu priu luftërave prej vitit 1940 deri në vitin 1947.

Ku kufijtë lëvizin nën aureolën e një prej luftërave më të mëdha të njerëzimit

Nëpër shumë vende zhvillohej lufta e përmasave shfarosëse. Nëpër kufijtë evropian ishte epiqendra. Në gjysmën e parë

të viteve dyzeta do të mbetën përjetësisht si ndodhia tragjike e planetit. Tashmë në përgatitjen për përfundimin e saj edhe shqiptarët e Kosovës kishin "pjesën" e tyre. Kufijtë lëvizin nën aureolën e një nga luftërat më të mëdha të njerëzimit. Në limitin e tyre janë të njohura luftërat e Kolashinit, të Bihorit në Rugovë kundër ekspansionistëve serbo-çetnik të cilët donin të pushtonin tokat shqiptare të Kosovës. Ishin vitet 1942, 1943, 1944. Siç shkruan njëri ndër më të përkushtuar për ndriçimin e veprimtarisë atdhetare të shumë personaliteteve, studiuesi Jetish Kadishani "pikërisht këtu zë fill aktiviteti luftarak e patriotik i prijësit trim e të paepur të ndërgjegjes shqiptare, komandant i Njësitit vullnetar të Bajrakut të Astrazupit-Qazim Bajraktarit ..." (Vijon)

Doli nga shtypi kompleti i pesë librave kushtuar Fazli Greiçevcit

PRISHTINË, 11 SHKURT - Ka dalë nga shtypi kompleti i pesë veprave letrare kushtuar mësuësit, poetit, heroit të Kosovës, Fazli Greiçevci. Në këtë komplet librash janë të përfshirë pesë libra: "Poeti që u shkri në diell", dy monografi: E para sjell tërë dosjen e ndjekjes e përndjekjes, burgimit, keq-trajtimin mizor të poetit e mësuësit Fazli, në burgun e Prishtinës, vrasja, dhe hedhja në gjyq e kriminelit çetnik-serb, Vlada Sheligoviqit, heroizmi i dr. Alki Sokolit, i cili nuk e nënshkroi dosjen e UDB-së, që përpiqej ta fshihet krimin, vrasjen e tij, dhe ta shpallin mashtrimin se Fazli Greiçevci ka vdekur nga një sëmundjeje e rrezikshme, dhe Monografia e dytë i kushtohet poetit e veprimtarit të shquar, nipit të Fazliut, Ymer Elshanit, të cilin po ashtu, çetnikët serbë e

pushkatuan me tërë familjen e tij, e mbeti gjallë vetëm vajza e madhe, Teuta; "Poeti, që hyri në përmendore", monografi; "Shqipëri ishim, Shqipëri jemi", i kushtohet flamurit kuqezi, të cilin Fazliu, as s'e shkeli, as s'e pështy, as s'e grisi me urdhrin e barbarëve udbashë, të ndihmuar edhe nga disa shqipfolës; "Flamur nga Drenica", i botuar në vitin 1991, kur për herë të parë zbardhet, në vargje, vrasja barbare e mësuësit, e poetit Fazli, bash në ditën kur, më 3 gusht 1991, populli zhvarrosi dhe rivarrosi eshtrat e birit të vet; "Fi - Fi - Guri", i kushtohet Flamurit, djalit të vetëm të Fazliut, i cili dha shpirt në Turqi...

Këto vepra i shkroi e i botoi vetë shkrimtari, publicisti, gazetari Riza Greiçevci, i cili me Fazliun ishin fëmijë të dy vëllezërve.

(I. HOTI)



Më 16 shkurt çelet ekspozita retrospektivë e piktores Alije Vokshi në GMK

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Më 16 shkurt, në orën 19:00, në Galerinë e Ministrisë së Kulturës (GMK) bëhet hapja e ekspozitës së parë në kuadër të Programit Artistik të Galerisë së Ministrisë së Kulturës për vitin 2018.

Galeria e Ministrisë së Kulturës e nis këtë vit me ekspozitën retrospektivë të piktores së mirënjohur Alije Vokshi.

Piktorja Alije Vokshi është grua e parë shqiptare nga Kosova që diplomoi për pikturë. Vokshi

ka lindur në vitin 1945 në Prishtinë. Ka mbaruar Shkollën Pedagogjike në Prishtinë, ndërsa ka përfunduar studimet e magjistraturës në Beograd në vitin 1981. Ajo kreu edhe një vit specializim në Paris, më pastaj u angazhua deri në pensionim, si ligjëruese në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës nga viti 1974-2015. Kjo ekspozitë retrospektive shpalos një pjesë të krijimtarisë së piktores Alije Vokshi dhe janë veprat e para me të cilat nisi

karrierën. Ekspozita vjen në Galerinë e Ministrisë së Kulturës si event i listuar edhe nën patronatin e presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e dhjetëvjetorit të pavarësisë së Kosovës. Ky projekt financohet nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës, ndërkaq drejtohet nga Dhurata Ramosaj-Shala, koordinatore e Galerisë së Ministrisë së Kulturës.



E rrallë

20 burra shtyjnë avionin 35 tonë

Rreth 20 punonjës të aeroportit "Tambolaka" në Indonezi janë fotografuar teksa shtynin një avion 35 tonësh. Ndërkaq në rrjetet sociale, kur është plasuar fotografia, komentuesit shkruan se avioni ishte prishur dhe ishin pasagjerët ata që po e shtynin.



FOTO E DITES



Fishekzjarrë në ceremoninë e hapjes së Lojërave Olimpikë Dimërore 2018 në Pyeongchang, Korenë e Jugut. /AP/

E jashtëzakonshme

Ndërtohet ura prej xhami, më e larta në botë

Fiksimi i Kinës me urat prej xhami ka arritur nivele të tjera. Pasi një urë të re prej xhami, është ndërtuar në lartësinë rreth dy kilometra në malin Malin Batai të Kinës një tjetër. Kjo është ura më e lartë në botë prej xhami duke thyer rekordin e mëparshëm që e mbante vetë Kina, me urën e xhamit Zhangjiajie që ndodhet në 548 metra lartësi.



BARSOLETA E DITËS



Doktori: Keni ngrenë mish?
Pacienti: Jo, nuk e ha fare mishin.
Doktori: Po, peshkun?
Pacienti: As peshkun nuk e ha.
Doktori: Ju qenkeni vegetarian.
Pacienti: Jo, jam gjakovar.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00

"FERDINAND"

3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.
Regjia: Carlos Saldanha



Në ora 18:00 dhe 20:00 (R) "FIFTY SHADES FREED"

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.
Regjia: James Foley



Në ora 22:00 (PG-13)

"THE COMMUTER"

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaime Collet-Serra



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Koha dhe përkushtimi që duhet t'i dedikoni vetes sot duhet të jetë ekskluzive dhe të mos ngatërrohet me problemet e personave të tjerë.



DEMI

Po përpiqeni të jeni me korrekt seç duhet dhe doni të evitoni gabimet. Por nëse nuk gaboni nuk keni për të mësuar asnjëherë nga gabimet tuaja.



BINJAKËT

Mundësitë që do t'ju ofrohen sot do t'ju japin kënaqësinë të përmirësoni mjaft gjërat tuajat që kishin ngërçe të mëdha dhe donin korrigjime.



GAFORRJA

Sot dita juaj do të nisë herët sepse duhet të zgjoheni që në orët e para të mëngjesit. Kjo do t'ju japë shumë energji për ta përballuar ditën.



LUANI

Nëse jeni të lidhur nga një marrëdhënie pune me persona të caktuar duhet të toleroni edhe sjellje që në jetën e përditshme nuk ju pëlqejnë.



VI RGJËR ESHA

Keni marrë masa dhe keni larguar nga vetja këdo që nuk ju ka pëlqyer. Në një moment të caktuar do të kuptoni që i keni larguar të gjithë.



PESHORJA

Sot as nuk duhet të merrni parasysh komentet e personave që i njihni pak dhe kanë një karakter dyshtes që nuk përçon asgjë.



AKREPI

Nëse doni t'i përngjani dikujt që ju e pëlqeni mundohuni të merrni anë të mirë të tij dhe jo ta imitoni duke dalë nga vetja.



SHIGJETARI

Keni besuar dhe keni mbështetur persona që tashmë ka ardhur momenti t'ju kthejnë mbrapsht gjithë besimin tuaj. Dita do të jetë e shkëlqyer.



BRICJAPI

Keni shumë mundësi për ta kaluar mirë ditën sot, por asnjëra prej tyre nuk do t'ju çojë në vendin që do të donit të ishit dhe me personin që do të donit.



UJORI

Edhe pse keni ndryshuar shumë gjatë kësaj kohe persona të caktuar nuk duan ta pranojnë këtë gjë. Do të vazhdojnë të vënë në dukje defektet tuaja.



PESHQIT

Duhet të jeni koherent me të tjerët, por aq më shumë me veten tuaj. Nëse keni bërë një premtim duhet ta mbani, pavarësisht prej rrethanave.

Toquel prezanton këngën "Karolina"



Edhe pse ka kohë që merret me muzikë, Toquel është bërë i njohur për publikun shqiptar falë projektit "Poppa Bottle", i cili ka qenë pjesë e "The Top List". Toquel, i cili prej shumë vitesh merret me muzikë, ka zgjedhur tregun grek për

ta prezantuar muzikën e tij por, së fundmi, ai gjendet i pranishëm edhe në tregun shqiptar. "Karolina" mban titullin prurja më e re e këngëtarit, e cila është bërë menjëherë pjesë e 100 këngëve më të bukura të muzikës moderne shqiptare.

Butrinti transformon trupin pas ushtrimeve të rregullta në palestër



Këngëtari Butrint Imeri vazhdon të jetë një ndër më të pëlqyerit nga moshat e reja. I njëjti është shumë i ndjekur në rrjetet sociale, në të cilat është mjaft

aktiv. Shpesh ai preferon të ndajë me fansat imazhe nga jeta e tij e përditshme. Së fundmi, ai ka treguar se ka filluar të merret me ushtrime në palestër.



Një baba i përkushtuar si David Beckham

Victoria Beckham është duke punuar shumë në Nju Jork, pasi në javën e modës ajo do ta prezantojë koleksionin e saj të ri. Dhe për të qëndruar sa më pranë bashkëshortes së tij, ylli i

futbollit, David Beckham, ka marrë fëmijët, Harper, Romeo and Cruz, dhe kanë zbardhur në Nju Jork. Davidi është fotografuar në aeroport, ku shfaqet mjaft i përkushtuar me fëmijët.

Shqiptari fiton në Festivalin "Sanremo" në Itali



Këngëtari shqiptar Ermal Meta dhe Fabrizio Moro janë shpallur fitues të festivalit "Sanremo". "Non mi avete fatto niente" titullohet kënga e tyre e cila do ta përfaqësojë Italinë në "Eurovision". Pjesëmarrja e Ermalit në këtë festival bëri shumë bujë,

ngaqë ishte vlerësuar se kënga është plagjiat dhe ishte pezulluar nga gara me vendim të organizatorëve të festivalit. Ky lajm ka gëzuar të gjithë shqiptarët, artistët dhe shumë prej fytyrave të tjera publike, të cilët kanë uruar Ermalin për arritjen, duke thënë se ndihen krenarë.



						Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA NË FOTO DHURATA	BARKË QË SHËRBEU PËR TË MBARTUR MALLRA NËPËR LUMENJ (sh.shq.)	KUSAR I ANIJEVE	SHKRONJË GREKE	AKTORJA E FAMSHME WILSON	ZANORE	EPOKA ERE	KLUB I YNI FUTBOLLI	LLOJ PIJE ALKOOLIKE	HAJDE	ANALISTI SHQIPTAR MUSTAFA	
						NJËSIA PËR TË MATUR FUQINË E RRYMËS ELEKTRIKE							KËNGËTARI ... ABASI BASHKËT.					
						SHTET NË AMERIKË						QYTET NË SHQIPËRI AI QË ZOTËRON NJË PASURI A DIÇKA TJETËR						
						ISH FUTBOLLISTI EDVIN							SIMBOL I FESË MYSLIMANE, BESIM QYTET I MADH NË GJERMANI (shqip. - shq.)					
						GYP NËPËR TË CILËT KALON GJAKU (shq.)				QË ËSHTË LËNË I LIRË QË NISËT VETËM NGA DOBIA E ÇASTIT (fem.)				JOD, AMPER, OKSIGJEN		ZANORE AKTORJA E FAMSHME ITALIANE MUTI		
						TATUAZH					SHTET FEDERAL NË SHBA (shqip.) DIJETAR FETAR MYSLIMAN						KRYEQYTETI I SENEGALIT	
						AGIM TEJECI			FRIKËSOVE (blsed.) PJESE E TELEVIZORIT					AKTORI YNË ... ISLAMI GAMBERINI (shq.)				
						BASHKËT.		KANDËRR E VOGËL ME NGJYRË TË ZEZË (shq.) HUQ, VES										
EPOKA ERE	POEMË E VOGËL OSE VJERSHË, NË VARGJE TË RREGULLTA	HUMORISTE E JONA	KILOGRAMET (krah.)	DY ZANORE	MONACO		PJESË E LIMANIT (sh.pashq.) LLOJ HELMI LUFTE					DY ZANORE I RI TAKOVE			EDUARD KROS FUTBOLLISTI TURK BELOZOGLU			
FUTBOLLISTI ANGLEZ DEJVID						SANACIONI, PËRMIRËSIMI LUMË NË SHQIPËRI							NJË LLOJ DHEU I BARDHË SI DELTINË EMER I VJETËR PËR LUBJANËN					
LETRARI ALI					SHËNDET-ËSORE BREJTËS I VOGËL									MARTIN (shk.) KËNGËTARJA LIBOHOVA				
KËNGËTARJA ME FAMË BOTËRORE ... KIM				AKTORJA BUDAKOVA SHKRIMTARI HAZIRI (shq.)						EMËR YNI MASHKULLI ZANORE					ZANORE ISH PRESIDENTI AMERIKAN HARRY			
ANËTARËSIMI NË NJË PARTI POLITIKE							ARË E MBJELLË ME ORIZ (sh.shq.) BASKETBOLLISTI TURK ONAN										DISIPLINË SPORTIVE	
DITA E SHËNUAR NË KALENDAR					QILIM I VOGËL QË SHTROHET ANËS VATRËS USHTRIA E SHQIPËRISË					TENISTJA KURNIKOVA EDITA SOPJANI					DY BASHKËTINGËLLORE			
AKADEMIA E SHKENCAVE			SEKRETARI I OKB-së BAN KI ... VEND I ÇEKËT NË NJË LUMË				NOTË MUZIKORE LLOJ BIME NARKOTIKE			LLOJ GAZI PA NGJYRË KËNGËTARJA JONË E VJETËR TAKE					"URUGUAI" SMALTI			
EPOKA ERE	PA U NXITUAR, NGADALË POEZIA E DASHURISË						"KENIA" SUPER MODELJA KATE ...		KAMPIONE (Sport) FRIKAKAKE, IKANAKE				AKTORJA HOLLIVUDIANE ... MOORE RADIO TELEVISYEN MALAYSIA					
LETRARI ... MEKULI					HUMANISTI BIÇIKEMI BASHKËT.					KALLI MISRI KËNGËTARJA CANI								
"RISANI"			NIS TË ZBARDHË DITA GJINI E KRIJIMTARISË LETRARE				VLERË, DOBI GËZIM I MADH							NËNË (turq.) EPOSI				
AKTORI AMERIKAN WILSON (shqip.)					ORA (turq.) DY ZANORE							AKTORI I NJOHUR GIBSON KËNGËTARJA ZAHARIA				TOTENHAM KËNGËTARJA GJERMANE ... KONOR (shqip.)		
DOKUMENT I VJETËR MBI PRONËSINË E TOKËS						E SHTËNË ME DISA ARMË ZJARRI NJËHERËSH METER, ERBIUM							I PISTË MATH KERNEL LIBRARY				LUAJ	
KUNDREJT I VJETËR				DRAMË E SANTORIT LLOJ DRURI					EMËR MASHKULLI MYSLIMAN						AKTORI HOLLIVUDIAN ... PAÇINO BASHKËT.			
MAJA E MPREHTË E NJË MALI					KUNDËRSH-TAR I BOL-SHEVIZMIT RUS ZANORE					KLUB FUTBOLLI NË SUEDI RAVENA				PËR (huaj)				
ZANORE		KASOLLE PËR KAFSHËT (shq.)												LËNDË DJEGËSE E LËNGËT				

Ana, gruaja që shpëtoi Dostojevkin nga kumari

Në verën e vitit 1865, kur sapo kishte nisur të shkruante “Krim dhe ndëshkim”, një nga romancierët më të mëdhenj të të gjitha kohërave nuk ishte në gjendjen e tij më të mirë. I mbetur i ve, Dostojevski humbi edhe të vëllain. I mbytur në borxhe për shkak të vesit të kumarit, Dostojevski trashëgon edhe borxhet e të vëllait dhe shumë shpejt kreditorët nisën t’i trokisnin në derë, duke e kërcënuar me burg. (Një dekadë më herët, ai mrekullisht i kishte shpëtuar dënimit me vdekje për shkak të leximit të librave të ndaluar).

I dëshpëruar, shkrimtari pranoi të shiste të drejtat e një koleksioni historish dhe pjesë e marrëveshjes ishte edhe një roman i ri me të paktën 175 faqe që duhej të ishte gati në nëntorin e një viti më pas. Duke mos pasur rrugëzgjdhje, Dostojevski vendosi të përmbyste kontratën, por ishte kaq i përfshirë nga “Krim dhe ndëshkim” sa e kaloi gjithë vitin duke punuar mbi të në vend që të shkruante romanin “Kumarxhiu”, që ishte pjesë e kontratës.


Me ardhjen e tetorit, Dostojevski duhej të shkruante gjithë romanin në 4 javë. Më 15 tetor ai i kërkoi një miku që t’i sugjeronte një stenograf të mirë. Pa hezitim,

miku profesor i sugjeroi emrin e një gruaje të re, Ana Grigoryevna Snitkina. 20-vjeçarja u entuziazua nga oferta; Dostojevski ishte shkrimtari i preferuar i babait të saj dhe ajo ishte rritur me librat e tij. Të nesërmen ata filluan punën: ai diktonte, ajo shtypte në makinë.

Gjatë 25 ditëve në vijim, Ana shkonte çdo ditë në shtëpinë e shkrimtarit. Çdo ditë ai bëhej më i qetë dhe më i sjellshëm me vajzën. Me ndihmën e Anës, Dostojevski arriti ta përfundonte librin në kohë.

Në përfundim të punës, ai e pagoi dhe e falënderoi. Ditën tjetër, me rastin e 45-vjetorit të tij, Dostojevski vendosi të organizonte një drekë, ku ftoi edhe Anën. Në atë drekë ai kuptoi se Ana ishte bërë drita e ditëve të tij dhe se puna me të i jepte kënaqësi. Duke mos e imagjinuar më jetën pa të, ai i kërkoi ta ndihmonte që të përfundonte “Krim dhe ndëshkim”.

Më 20 nëntor, 10 ditë pas përfundimit të projektit të parë, ai e ftoi Anën në shtëpinë e tij. Të dy u futën në studion e tij, ku ai i propozoi martesën në mënyrën më të mrekullueshme. Dostojevski i tha Anës se do të donte të dinte mendimin e saj mbi një roman që po shkruante.



Por sapo nisi t’i tregonte historinë u bë e qartë se për çfarë bëhej fjalë, ishte historia e atyre të dyve. Ata u martuan më 15 shkurt 1867. Edhe pse patën vështirësi financiare dhe përjetuan tragjedi

familjare, përfshirë humbjen e dy fëmijëve të tyre, ata e deshën njëri-tjetrin dhe qëndruan bashkë deri në vdekjen e shkrimtarit. Pas vdekjes së tij, Ana studioi tregun e botimeve dhe punoi fort

duke e bërë të shoqin një markë kombëtare, librat e cilit u shitën në miliona kopje. Sot shumë e konsiderojnë atë si gruan e parë që drejtonte një biznes në Rusi. (gazeta-Shqip.com)

Gjermani, tani mund të punohet 28 orë në javë për dy vjet

Marrëveshja ndërmjet sindikatave dhe kompanive në rajonin e Baden-Wuerttemberg: rritja e listës së pagave prej 4.3% dhe e drejta për të shkurtuar javën e punës për një periudhë maksimale prej dy vjetësh

Një javë prej 28 orësh pune për ata që duhet të ndihmojnë të afërmit dhe fëmijët dhe një rritje në listën e pagave prej 4.3%. Sindikata e metalurgjisë gjermane Ig Metall arrin një fitore të bukur që përfundoi në Shtuttgart. Akronimi, i cili grumbullon punëtorë në sektorët metalurgjik dhe elektrikë – 3.9 milionë në nivel federal – është kjo marrëveshje e fundit për Tokën e Baden-Wuerttemberg, duke sjellë në shtëpi jo vetëm një rritje të pagës prej 4.3% nga prilli, por edhe e drejta për të shkurtuar javën e punës për një periudhë maksimale prej dy vjetësh.

Risiti – Rregullat e reja do të zbatohen për 900 mijë punonjës në këtë sektor. Të gjithë ata që kanë nevojë për të ndihmuar të afërmit ose fëmijët e moshuar ose të sëmurë do të kenë të drejtën të

kërkojnë javën e 28 orëve, për një periudhë që varion nga një minimum prej 6 muaj deri në një maksimum prej 24. Pas kësaj, punonjësi automatikisht do të kthehet në 35 orë nga kontrata origjinale.

Sindikata nuk ka arritur të marrë miratimin e një rregullimi të rrogës, që thuhet në shkallën e parë: kushdo që zgjedh këtë opsion do të shohë një prerje proporcionale në pagë. Por kjo mund të kompensohet me 8 ditë pushim pune.

Nga ana tjetër, ekziston mundësia që kompanitë të rrisin kontratat 40-orëshe të dakorduara deri më tani me punonjësit e tyre.

Kush do të bashkohet? Marrëveshja erdhi direkt pas mobilizimit të javëve të fundit, të cilat e kishin çuar sindikatën drejt këtyre 24 orëve abstenim nga



puna. Homologu i punëdhënësit kishte frikë se kjo gjë do të përfundonte me fund të hidhur dhe do të jepnin rrugë. Suddeutsche Zeitung, gazeta e qendrës së

majtë, flet për një “bast”. “Pjesa më e fortë e marrëveshjes është ajo që lidhet me rritjen e pagave, – lexojmë, – pasiguria përfaqësohet nga koncesioni në

afatin kohor. Sa punëtorë do të përfitojnë pyetet shtypi – të cilët me të vërtetë do ta kërkojnë atë në ditën e shkurtimit të pagës?”

(gazeta-Shqip.com)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	CHELSEA - WEST BROM	1-1	ST PAULI - NURNBERG	GG3+	HOBRO - AGF AARHUS	GG3+
-------------------	---------------------	-----	---------------------	------	--------------------	------

Sukseset e xhudos s'kanë të ndalur

Akil Gjakova e ka shkruar edhe një faqe të re të historisë së sportit të Kosovës në garat ndërkombëtare, pasi me triumfin në Paris është bërë xhudisti i parë nga Kosova që fiton medaljen e artë në një Grand-Slam. E suksesshme në këtë garë doli edhe Distria Krasniqi, e cila e rrëmbej medaljen e bronzitë. Drejtuesit e shtetit kanë vlerësuar se këto medalje janë dhurata më e mirë për 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës



argjendte, me gjithsejtë pesë luftëra të fituara.

Akil Gjakova: Ndjenjë e mirë ta mposhtësh kampionin olimpik

Akil Gjakova në një intervistë për IJF-në ka zbuluar se çfarë ndjenje është ta mposhtësh kampionin olimpik dhe emocionet që përjetoj në Grand Slamin e Parisit. "Është ndjenje shumë e mirë ta fitosh Grand Slamin. Kjo është e para mua dhe është e artë. Jam i lumtur. Pata një ditë shumë të mirë. Isha në formë shumë të mirë. Mposhta kampionin olimpik dhe kjo është shumë mirë për mua dhe kjo më motivon për më shumë. Çfarë ndjenje është ta mposhtësh kampionin olimpik? Është ndjenje shumë e mirë. Thjesht kam hyrë në meç për të fituar. Pata një ndjenje të mirë dhe një moment të mirë, prandaj fitova", ka thënë Gjakova, i cili bëhet xhudisti i parë nga Kosova që arrin medalje në Grand Slam. "Po, është medalja e parë për meshkujt. Kjo është ndjenje e mirë pasi gjeneratat e reja mund të motivohen sepse mund t'i shikojnë xhudistët si në këtë rast dhe të stërvitin më shumë", ka deklaruar Gjakova.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 11 SHKURT - Sukseset e sportit të xhudos, në krye me trajnerin Driton Kuka, nuk kanë të ndalur. Akil Gjakova është sportisti i radhës nga ky sport që e bën Kosovën krenare, duke i sjell medaljen e artë nga Franca, pasi në finalen e Grand-Slamit të Parisit e mposhti Lasha Shavdatuashvili. Pas këtij triumfi, përzgjedhësi i Kosovës në xhudo, Driton Kuka, ka thënë se medalja e parë e artë nga xhudisti Gjakova është dhuratë për 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. "Mbreti i Parisit që flet Shqip! Dhurata për 10 vjet shtet! Akili i artë në Grand Slam Paris, kurse kampioni olimpik i gjunjëzuar në finale", ka thënë Kuka. Përveç Akilit, medalje në Francë ka siguruar edhe Distria Krasniqi, e cila është stolisur me medaljen e bronzitë, pasi e ka mposhtur xhudisten japoneze

Natsumi Tsunoda. Kjo është medalja e parë e bronzitë për Distrian, përkatësisht e dyta në këtë fillimvit, pasi ajo e fitoi të argjendtën në muajin e kaluar në Tunizi. Suksesin e Akilit dhe Distrias e kanë përshëndetur edhe drejtuesit e shtetit. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka shkruar në "Facebook": "Vetëm një javë para shënimit të jubileut të pavarësisë së Kosovës, Akil Gjakova, me medaljen e artë që e fitoi në Grand Slamin e xhudos në Paris, njëherësh medaljen e parë të artë, shtetit tonë në arenën ndërkombëtare në kategorinë e meshkujve, dhe Distria Krasniqi, me medaljen e bronzitë në po të njëjtin kampionat, ia sjellin dhuratën më të mirë republikës sonë në ditëlindjen e saj të dhjetë. Urime të përzemërta Akilit, Distrisë, trajnerit Driton Kuka dhe të gjithë dashamirëve të sportit

tonë. Krenar me sportistët tanë, ambasadorët më të mirë të Kosovës". Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka vlerësuar se ky brez i ri i vajzave e djemve po i dhurojnë atdheut shumë dashuri në jubileun e dhjetë të pavarësisë. "Shkëlqimi i artë i Akil Gjakovës dhe e bronzta për Distrian na bënë sot krenarë. Ky brez i ri i vajzave e djemve po i dhurojnë atdheut shumë dashuri në jubileun e dhjetë të pavarësisë duke e ngritur lart flamurin e Kosovës kudo në botë. Akil Gjakova e Distria Krasniqi, urime dhe faleminderit! Urime Kosovë!", ka thënë

Haradinaj. Ndërsa kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, medaljet e fituara në Paris i vlerëson si dhurata të mira për 10-vjetorin e pavarësisë. "Faleminderit Akil dhe Distria! Dhurata më e mirë në 10-vjetorin e pavarësisë!", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook". Sukseset e xhudos të arritura në Paris nuk ishin të vetmet ditë e shtunë, sepse xhudistja e re Erza Muminoviq është xhudistja e radhës që ka shkëlqyer në kupën evropiane për kadetë, të mbajtur në Follonika të Italisë, duke u stolisur me medalje të



Shtyhet debutimi i Tahirit në Lojërat Olimpike Dimërore

PYEONGCHANGUT, 11 SHKURT - Është shtyrë gara në disiplinën lëshim i shpejtë, ku ishte paraparë të garonte skitari nga Kosova, Albin Tahiri, në Lojërat Olimpike Dimërore "PyeongChang2018". Sipas

njoftimit të Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), shkak për këtë shtyrje janë bërë erërat e forta të cilat po mbretërojnë në Qendrën Skitare Jangseon, rreth 40 km larg PyeongChangut të Koresë së Jugut. Kjo garë do të

mbahet më 15 shkurt, kurse gara e 15 shkurtit, e paraparë të mbahej në super slalom të madh, është shtyrë për më 16 shkurt. Garën e ardhshme Albini do ta ketë të martën (13 shkurt) në kombinim alpik.

Donjeta Sadiku, e artë në Hungari

Prishtinë, 11 shkurt - Boksierja Donjeta Sadiku e ka fituar medaljen e artë në turneun ndërkombëtar të mbajtur në Hungari. Sadiku është sportistja e radhës që i sjell medalje të artë shtetit të Kosovës, pasi arriti me një paraqitje të shkëlqyeshme të triumfojë në turneun

ndërkombëtar "Bocskai Istvan" të mbajtur në Debrecen të Hungarisë. Boksierja nga Kosova në finale e mposhti boksieren kroate Sara Behram dhe në fund fitoi medaljen e artë. Vlen të theksohet se në gjysmëfinale, Donjeta fitoi ndaj hungarezes Olah Eszier, e

cila e ndërpreu meçin në raundin e dytë. Kështu, Donjeta edhe një herë konfirmoi se nuk është rastësisht nënkampione e botës në vitin 2015 dhe kampione e Evropës në vitin 2016 dhe nënkampione evropiane në vitin 2016, në konkurrencën e juniorëve.



Më 17 shkurt nis stinori pranveror në hendboll

PRISHTINË, 11 SHKURT - Ndeshjet e para të stinorit pranveror në Superligën e Kosovës në hendboll për meshkuj luhen më 17 e 18 shkurt. Në program do të jenë ndeshjet e javës së 15-të të kampionatit të Kosovës.

Stinorin vjeshtor në pozitën e parë e ka mbyllur kampionia aktuale, Besa FamGas, që i ka fituar të gjitha 14 ndeshjet. Prishtina është e dyta me 26 pikë, përkatësisht me 13 fitore e një humbje. Humbjen e vetme

e ka pësuar pikërisht nga Besa. Pasojnë Drita me 20 pikë e Kastrioti me 15. Në mesin e tabelës janë Trepça e Zhegra me nga 13 pikë, ndërsa pas tyre renditen Vushtrria me 11 e Vëllaznimi me 8. Në dy pozitat

e fundit renditen Samadrexha e Llapi me nga dy pikë. Ndërkohë kampionati në Superligën e femrave vazhdon më 24 shkurt. Garat pranverore në Ligën e parë, në të dy konkurrencat, nisin më 10 mars.



Medaljet e ditës së parë në LOD



PYONGCHANG, 11 SHKURT - Pas Charlotte Kale, të tjerë sportistë fituan medalje në Lojërat Olimpikë Dimërore. Në garën e biatlonit prej 7.5 km për femra, medaljen e artë e fitoi gjermania Laura Dalmajer, me 21 minuta e 6 sekonda, e ndjekur në vendin e dytë nga norvegjezja Marte Osblu, me 24.2 sekonda më shumë, ndërsa medaljen e bronzit e fitoi çekja Veronika Vitkova, me 21 minuta e 32 sekonda më shumë. Në garën e

shpejtësisë në akull 3 000 metra për femra, dominuese ishte Holanda. Medaljet e arta, argjenta dhe bronza u fituan pikërisht nga sportistët holandezë. Vendin e parë e fitoi Karlin Ahterekte, e ndjekur në të dytin dhe të tretin nga Iren Vust dhe Antuanete De Jong.

Në garën e shpejtësisë në akull, në pistë të shkurtër 1 500 metra për meshkuj, medalja e artë i shkoi koreano-jugorit Lim Hjojun. Medaljen e argjendte e

fitoi holandezi Knekt, ndërsa medalja e bronzit i shkoi sportistit rus që garoi me flamurin e Lojërave Olimpikë, Semen Elistratov. Në garën individuale të kërcimit nga trampolina për meshkuj ishte gjermani Vellinger ai që fitoi medaljen e artë me 259.3 m. Në vendin e dytë, me medaljen e argjendte u rendit norvegjezi Forfang, ndërsa në të tretin, duke fituar edhe medaljen e bronzit, u rendit Robert Johanson, edhe ky nga Norvegjia.

Golden State, leksion edhe San Antonios

OAKLAND, 11 SHKURT - Golden State ka hequr çdo dyshim se është skuadra më e mirë në NBA, duke mposhtur edhe San Antonion, një nga rivalet për titull në Konferencën e Perëndimit. Skuadra e Warriorsit mposhti 122-105 Spursin në një ndeshje në përgjithësi të dominuar nga vendësit, që patën epërsi në shumicën e kohës. Thompsoni me 25 pikë ishte shënuesi më i mirë për Golden Staten, ndërkohë që 41 pikë u realizuan nga lojtarët e stollit, që bënë diferencën në këtë sfidë për vendësit. Për Spursin, Aldridge e Andersoni realizuan



nga 20 pikë secili, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Fiton edhe Dallas, që ndali 130-123 Lakersin, pas një ndeshje spektakolare dhe me rivalitet, ku të dyja ekipet e kërkuar suksesin.

Veterani Nowitzki realizoi 22 pikë për Dallasin, mbështetur nga Barnes me 21, ndërsa për Lakersin nuk mjaftuan 26 pikët e Randles dhe 22 të Isaiah Thomasit, që debutoi me skuadrën e re.

SHKURT

Zenga lavdëron Ajetin

Arlind Ajeti ishte protagonist me skuadrën e Crotones teksa mori një pikë përballë Atalantës së Etrit Berishës, gjithashtu edhe duke asistuar tek goli. Përveç asistimit, ra në sy edhe pozicionimi para linjës së mbrojtjes. Trajneri Zenga e aktivizoi si mesfushor me tipare mbrojtëse, por edhe për të ndihmuar në krijimin e aksioneve të reja. E, duke parë performancën e mirë të shqiptarit, nuk munguan as lavdërimet pas ndeshjes. "Gjatë javës ne kërkojmë zgjidhje alternative dhe pozicioni i Ajetit ishte ndër gjërat që kemi provuar. Ai u tregua i gatshëm për të luajtur, për të provuar gjëra të reja dhe gjithashtu asistoi në gol", ka thënë deklaroi Zenga.

Premierë Liga, e ardhmja e Enriques

Ish-trajneri i Barcelonës dhe Romës, Luis Enrique, ka vendosur t'i rikthehet punës së trajnerit. Ai dëshiron të bëhet trajner në një skuadër të Premierë Ligës. Lajmin e ka konfirmuar "Mundo Deportivo". Ai kërkohet nga Chelsea dhe Arsenali, ku Antonio Conte respektivisht Arsene Wenger pritet të largohen në fund të këtij edicioni.

Di Maria: Isha afër Barcelonës

Ylli i PSG-së, Angel Di Maria, ka konfirmuar se ishte afër transferimit të Barcelona në afatin kalimtar të verës. "Është e vërtetë se agjentët e mi ishin në bisedime me Barçën dhe unë ndodhesha shumë pranë kalimit në 'Camp Nou', por në fund gjithçka dështoi. Tashmë jam i lumtur që kam qëndruar te PSG pasi viti 2018 ka nisur në mënyrën e duhur për mua", ka thënë Di Maria, i cili ka luajtur edhe për Manchester Unitedin dhe Real Madridin.

Verratti: Jemi gati për Realin

Real Madridi dhe Paris Saint-Germaini do të përballen të mërkurën në 1/16 të Ligës së Kampionëve në "Santiago Bernabeu". Mesfushori i parisienëve, Marco Verratti, beson se janë gati për t'u ballafaquar me kampionin, por trajneri Unai Emery ende nuk e di me cilët lojtarë të luajë në Spanjë. "Mendoj se jemi gati për Real Madridin. Është ndeshje shumë e rëndësishme, shumë e rëndësishme për sezonin. Është bukur për ne, lojtarët, për tifozët - do të luajmë kundër një ekipi të shkëlqyer në një stadium të mrekullueshëm. Duhet të jemi të fokusuar", ka thënë Verratti për "Canal Plus". "Mendoj se përballja është 50-50 mes nesh dhe Real Madridit. Ata do të japin gjithçka, sepse kanë lojtarë të shkëlqyer. Ndërsa ne kemi dy "punonjës" fantastikë të ri, Kylian [Mbappe] dhe Neymar", ka deklaruar Verratti.

Mourinho kundër shkuarjes së De Geas në Real

Rikthehen zërat që flasin për dëshirën e Realit të Madridit për ta blerë kartonin e David De Geas nga Manchester United. Ai që përipiqet të frenojë gjithçka në këtë histori është trajneri i "djavës të kuqe", Jose Mourinho, që nuk ka ndërmend të privohet nga shërbimet e portierit të përfaqësueses spanjolle. "Asnjë klub, që dëshiron të ketë më të mirët në radhët e saj, nuk ka ndërmend t'i largojë elementët më të vlefshëm të tij. Kjo është e pakuptimtë", ka thënë Mourinho. "Nëse dëshiron që të luash në nivelet më të larta, duhet të sjellësh në skuadër lojtarë më të mirë, siç bëme me Pogban, Matiqin apo Sanchezin, e ta pengosh largimin e atyre që dallohen më shumë", ka deklaruar Mourinho.

REZULTATET

Brooklyn - New Orleans	128-138
Orlando - Milwaukee	104-111
Philadelphia - Clippers	112-98
Chicago - Washington	90-101
Dallas - Lakers	130-123
Golden State - San Antonio	122-105
Phoenix - Denver	113-123



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia Pyjore e Kosovës
Agjencia za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

Sektori i Burimeve Njerëzore
Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa
Office of Personnel and Human Resources Development

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës NR.03/L-149 dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Miratimeve përmes SIMBNJ të pozitave nga DASHC-MAP me datë 06.02.2018, bënë:

SHPALJEN E KONKURSIT PËR KËTO VENDE PUNE

-I-

Titulli i pozitës: Zyrtar/e për Monitorim dhe Mbrojtje të Pyjeve
Ref: APK-03/18
Njësia organizative: Drejtorati Koordinues Regional i APK-së në Ferizaj
Vendi i punës: Ferizaj (1)
Nëpunësi Mbikëqyrës: Drejtori i Drejtoratit Koordinues në Ferizaj
Kategoria funksionale: Profesional
Grada e pagës (Koefficienti): Grada 9, Koefficienti 7
Lloji i pozitës së punës: E KARRIERËS (e përhershme)
Kohëzgjatja e periudhës provuese: dymbëdhjetë (12) muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Organizon, menaxhon dhe harton planet vjetore dhe planet operative të mbrojtjes së pyjeve nga faktorët abiotik dhe biotik, po ashtu harton planet vjetore të gjuetisë si dhe mbikëqyrë dhe monitoron zbatimin e tyre në terren;
- Organizon mbikëqyrë dhe monitoron strategjinë dhe mënyrën e ruajtjes së pyjeve nga faktori antropogjen dhe nga sëmundjet bimore;
- Koordinon dhe ndihmon punët me drejtorin përkatës në APK qendër, inspeksionin e pylltarisë si dhe Drejtorinë për Silvikulturë, Hulumtim dhe Prodhim fidanor;
- Mban kontakte me sektor përkatës në APK qendër si dhe raporton për gjendjen në teren për drejtorin koordinues të cilën vepron dhe sipas nevojës ndihmon;
- Harton raporte mujore, javore dhe periodike në sferën e mbrojtjes dhe monitorimit të pyjeve nga aktivitetet ilegale;
- Harton planet e mbrojtjes së pyjeve nga zjarri, sëmundjet dhe insektet si dhe ndikon në zbatimin e tyre në nivel regjioni;
- Nëpërmjet teknikut të këtij sektori pranon të dhënat për dëmet në pyje faktorët biotik dhe abiotik dhe propozon masat për sanimin e gjendjes së krijuar;
- Organizon bashkëpunimin me inspektor pyjesh dhe kontrollon të gjitha punët në këtë sektor si dhe vërteton gjendjen faktike në terren, si dhe merre pjesë në komisionet e ndryshme sipas nevojës së DKR të APK;
- Kujdeset për gjendjen shëndetësore të kulturave pyjore dhe fidanishteve dhe në konsultim me Drejtorinë për Silvikulturë, Hulumtim dhe Prodhim Fidanor i bien masat preventive për evitimin e sëmundjeve;
- Realizon dhe kryen punëve të tjera sipas urdhrat të Udhëheqësit për menaxhim me pyje në kuadër të DKR - APK -së.

Shkathtësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Së paku dy vjet përvojë pune në profesion
- Aftësi për vendimmarrje, planifikim, vendosjen e prioritetëve në punë dhe vetë iniciativë
- Fleksibilitet dhe aftësi për të përballur me situata të reja;
- Njohja e kompjuterit dhe aftësia për të përdorur me efekt Microsoft Office, pajisjet tjera të zyrës dhe pajisjet tjera të punës në teren,
- Zotimi i një prej gjuhëve zyrtare në të shkruar dhe në të folur në Republikën e Kosovës
- Aftësi për punë ekipore dhe motivim të ekipit,
- Zotësi për punë në mjedise shumetnike,
- Aftësia dhe gatishmëria për bashkëpunim dhe punë në terren.
- Aftësia për evitimin dhe shmangien e situatave konfliktuoze.
- Aftësia dhe gatishmëria për punë nën presion.
- Aftësi për përgatitje të raporteve, shkresave, kërkesave dhe informatave zyrtare.
- Të mos jetë i gjykuar për vepër penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar aktakuzë të plotfuqishme hetimore penale.

Nëse kandidati ka punuar apo punon në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës:

- Të ketë vlerësime pozitive të punës në dy (2) vitet e fundit nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë
- Të mos jetë në procedurë disiplinore dhe të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tri (3) vitet e fundit.

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

- Diplomë universitare -Fakulteti i Pylltarisë (konformë Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.16/2016 për Parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave ,gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe univeritare të fituara jashtë Republikës së Kosovës.

II.

Titulli i pozitës: Asistent/e administrativ/e 3
Ref: APK-04/18
Njësia organizative: Drejtorati Ligjor i APK-së
Vendi i punës: Prishtinë (1)
Nëpunësi Mbikëqyrës: Drejtori i Drejtoratit Ligjor në APK
Kategoria funksionale: Niveli tekniko-administrativ
Grada e pagës (Koefficienti): Grada 12, Koefficienti 5.5
Lloji i pozitës së punës: E KARRIERËS (e Përhershme),
Kohëzgjatja e periudhës provuese: Dymbëdhjetë (12) muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryerja e aktiviteteve në pranimin, evidentimin dhe protokollimin e shkresave, kërkesave dhe dokumenteve të tjera zyrtare,
- Udhëheq protokollin e shkurtër dhe atë të zgjeruar,
- Pranon dhe protokollon kërkesa nga palët e ndryshme të ndërlidhura me Drejtorin
- Pranimi dhe dorëzimi i shpenzimeve të Pety cash-it (parasë se imët),
- Shpërndarja e shkresave të ndryshme, vendimet, informatat, proceset etj. dhe mbajtja e evidences oficiale (takime, porosi, informime etj),
- Plotësimi dhe evidentimi i formularëve mbi ardhjen në punë të stafit në nivel drejtorie .
- Pranimi i postes dhe shpërndarja e sajë brenda APK si dhe mbajtja e evidences oficiale (takime, porosi, informime).
- Realizimi dhe kryerja e punëve të tjera sipas urdhrat të menaxherit të drejtpërdrejtë;

Shkathtësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Së paku 3 vite përvojë pune,
- Aftësi për planifikim, vendosjen e prioritetëve në punë dhe vetë iniciativë
- Njohja e kompjuterit dhe aftësia për të përdorur me efekt Microsoft Office, pajisjet tjera të zyrës,
- Zotimi i një prej gjuhëve zyrtare në të shkruar dhe në të folur në Republikën e Kosovës
- Zotësi për punë në mjedise shumetnike,
- Aftësi për përgatitje të raporteve, shkresave, kërkesave dhe informatave zyrtare,
- Gatishmëri dhe pedanteri në sistemimin dhe arkivimin e shkresave dhe dokumentacionit zyrtar,
- Korrektësi në mbajtjen e informacioneve dhe mos publikim e tyre pa autorizim
- Të mos jetë i gjykuar për vepër penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar aktakuzë të plotfuqishme hetimore penale.

Nëse kandidati-ja ka punuar apo punon në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës:

- Të ketë vlerësime pozitive të punës në dy (2) vitet e fundit nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë
- Të mos jetë në procedurë disiplinore dhe të mos jetë i ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore në tri (3) vitet e fundit.

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

- Arsimim i mesëm për administratë, ekonomike apo juridike

Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur edhe për kandidatë jashtë Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.

Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur edhe për kandidatë jashtë Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës.

Data e shpalljes së konkursit: 12.02.2018

Data e mbylljes së konkursit: 26.02.2018

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit NR.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Dokumentet duhet të jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Burimeve Njerëzore, zyra nr.2 në Agjencinë Pyjore të Kosovës, Rr. Zenel Salihu 1/A Prishtinë (prapa Muzeut të Kosovës).

Për informacione tjera shtesë kontaktoni në telefonin nr. 038-200-38-482 çdo ditë pune prej orës 8.⁰⁰ deri 16.⁰⁰.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia Pyjore e Kosovës
Agjencia za Šume Kosova
Kosovo Forest Agency

Sektor i Burimeve Njerëzore
Sektor Ljudskih Resursa
Office of Personnel and Human Resources Development

Na osnovu Zakona za Civilnu Službu Republike Kosova Br.03/L-149, Pravilnika Br.02/2010 za Procedure Rekrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosova i Usvajanja izdato preko ISMJALJR,sa pozicija od MJA, dana 06.02.2018, Raspisuje:

KONKURS ZA SLEDEĆA RADNA MESTA

-I-

Naziv pozicije: Službenik za praćenje i zaštita Šuma –BVP-350
Ref: AŠK -03/18
Organizaciona Jedinica: Regionalni Koordinacioni Direktorat AŠK-a u Ferizaj
Radno mesto: Ferizaj (1)
Nadzorni Službenik: Direktor Regionalne Koordinacione Direktorate AŠK-a u Ferizaj
Funksionalna kategorija: Profesionalni nivo
Nivo plate (Koeficient): Grada 9, koeficijent 7
Vrsta radne pozicije: KARIJERNE POZICIJE
Probni vremenski period: Dvanaest (12) meseci (neodređeno)

Zadaci i odgovornosti:

- Organizuje, upravlja i izrađuje opretnive i godišnje planove o zaštiti šuma od abiotičnih i biotičnih faktora, takođe izrađuje godišnje planove lovstva i vrši nadzor njihovih sprovođenja u terenu,
- Organizuje, i vrši nadzor strategiju i način zaštite šuma od antropogenih faktora i biljnih bolesti,
- Koordinira i pomaže poslove sa odgovarajućom direktijom AŠK-a-centar, inspekciju šumarstva i direktijom za Istraživanja i Proizvodnju sadnica,
- Održava kontakte sa odgovarajućim sektorom u AŠK-a-centar kao i izveštava za stanje na terenu sa KRD gde deluje i po potrebi pomaže,
- Izrađuje nedeljne, mesečne i godišnje izveštaje u oblost zaštite i nadzora šuma od ilegalnih aktivnosti,
- Izrađuje planove za zaštitu šume od požara, insekata kao i utiče na njihovo sprovođenje na nivou regiona,
- Preko tehničara ovog sektora prima podatke za šumske štete i abiotičnih od biotičnih faktora i predlaže mere sa saniranje ostvarenog stanja,
- Organizuje saradnju sa inspekcijom za šumarstu i kontroliše sve poslove u ovom sektoru kao i potvrđuje faktičko stanje na terenu kao i učestvuje u raznim komisijama po potrebi KRD- AŠK-a,
- Stara se o zdravstvenom stanju šumskih kultura i rasatnika i konsultaciju direktijom za Istraživanja i Proizvodnju sadnica,
- Realizuje i izvršava i ostale poslove po nalogu Rukovodioca RKD u AŠK,

Ključne veštine, sposobnosti i iskustvo :

- Najmanje dve godine iskustva u profesiji,
- Sposobnost za odlučivanje, planiranje, ispostavljanje prioriteta u radu i smoinicijativu,
- Fleksibilnost i sposobnost da se suoči sa novim situacijama,
- Poznavanje kompjutera i sposobnost za efektanu upotrebu Microsoft Office, druga kancelarijska oprema i osatla terenska prema,
- sposobnost upoznavanja jednog od službenog jezika pismeno i usmeno na Republici Kosova,
- Sposobnost za timski rad i motovisanje tima,
- sposobnost za rad u multietničkim sredinama,
- Sposobnost za izbegavanje konfliktnih situacija,
- Sposobnost i spremnost za rad pod pritiskom,
- Sposobnost za pripremu izveštaja, dopisa, zahteva i službenih informacija,
- da nije kažnjen za krivično delo sa pravosnažnom odlukom i da nije pokrenuta nikakava krivična istraga.

Ako su kandidati radili ili rade u Civilnoj Službi Republike Kosova:

- Dve (2) zadnje godine da ima pozitivne ocene od svog neposrednog rukovodioca,
- Da nije u disciplinskoj proceduri i da nije kažnjen sa disciplinskim merama u tri (3) zadnje godine.

Obrazovna i strucna kvalifikacija za ovu poziciju:

-Universitetska obrazovanje-Šumarski Fakultet (shodno Administrativnog Uputstva (MPNT) Br16/2016 za načela i procedura poznavanja diploma, činova i kvalifikacija visokih škola, visokih profesionalnih škola i universitetnih, dobijenih van Republike Kosova.)

II.

Naziv pozicije: Administrativni/a asistent/kinja
Ref: AŠK -04/18
Organizaciona Jedinica: Pravna Direkcija AŠK
Radno mesto: Prištini (1)
Nadzorni Službenik: Direktor Pravna Direkcija AŠK
Funksionalna kategorija: Admisitrativni-tehnički nivo
Nivo plate (Koeficient): Grada 12, koeficijent 5.5
Vrsta radne pozicije: KARIJERNE pozicije (neodređeno),
Probni vremenski period: Dvanaest (12) meseci

Zadaci i odgovornosti:

- Izvršenje aktivnosti na prijemu, evidentiranje i protokolisiranje spisa, zahteva i ostale službene dokumentacije,
- Vodi skraćeni i prošireni protokoll,
- Prima i protokoliša zhatave od raznih stranka vezane sa direktorom
- Prijem i isporuka troškova Pety Cashe (sitnog novca) ,
- Raspoređivanje raznih spisa , odluka, informacija , postupke, itd . i Održavanje službene evdenvije (sastanci , isporuke , informacije itd) ,
- Popunjavanje i evidentiranje obrazaca o dolasku na posao osoblja u nivo Direkcije.
- Prijem pošte i njihova raspodela unutar AŠK-a kao i održavanje oficijelne evidencije (sastanke, narudbi, informacije)
- Realizacija i izvršenje drugih poslova po nalogu direktora Direkcije

Ključne veštine, osposobljenost i iskustvo :

- Najmanje tri (3) godine radnog iskustva
- sposobnost za planiranje, ispostavljanje prioriteta u radu i samoinicijativu.
- Poznavanje kompjutera i sposobnost za efektanu upotrebu Microsoft Office, druga kancelarijska oprema ,
- sposobnost upoznavanja jednog od službenog jezika pismeno i usmeno na Republici Kosova
- Sposobnost za rad u multietničkim sredinama,
- sposobnost za pripremu izveštaja, spisa, zhatava i službenih informacije,
- spremnost i pedantinost u sistematizaciji i arhivisanju spisa i službene dokumentacije,
- korektnost na održanje informacija i njihovo neobjavlivanje bez ovlašćenja,
- da nije kažnjen za krivično delo sa pravosnažnom odlukom i da nije pokrenuta nikakava krivična istraga.

Ako su kandidati radili ili rade u Civilnoj Službi Republike Kosova:

- Dve (2) zadnje godine da ima pozitivne ocene od svog neposrednog rukovodioca,
- Da nije u disciplinskoj proceduri i da nije kažnjen sa disciplinskim merama u tri (3) zadnje godine.

Obrazovna i strucna kvalifikacija za ovu poziciju:

-Srednja obrazovanje za upravno, privrednu ili pravnu

Procedura konkurisanja:

Jeste otvorena i za kandidate van Civilne Službe Kosva.

Datum proglašenja konkursa, 12.02.2018

Datum sključenja konkursa, 26.02.2018

Civilna Kosovka Služba pruža jednake mogućnosti zaposlenja svim državljanima Kosova i prima aplikacije svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica u Kosovo.

Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju prave da budu predstavljeni proporcionalno na organima Javne Službe na lokalnim i centralnom nivou ,kao što je naznačeno i čl.11, paragraf 3 Zakona Br/03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova.

Nekompletirane dokumentacije se neće uzeti u obzir.

Dokumenti treba biti fotokopije jer se neće vratiti.

Postupak konkurisanja: Obrazci za konkurisanje se mogu dobiti i dostaviti Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa, kancelarija br.2 pri Agenciji za Šume Kosova, Ul. Zenel Salihu nr. 1/A Priština (iza Muzeja Kosova).

Za dodatne informacije kontaktirajte na telefon br. 038-200-38-482 svakog radnog dana od 8.00 do 16.00 časova.



KONKURS PËR VEND TË LIRË PUNE

Banka Ekonomike, Zyra Qendrore shpall konkurs për plotësimin e vendit të punës:

Programer (1 vend pune)

Departamenti i Teknologjisë Informative

Detvrat dhe përgjegjësitë :

- Programon në mënyrë individuale dhe ekipore sipas projektit të propozuar;
- Analizon, dizajnon, zhvillon, teston dhe instalon aplikimin sipas detyrës projektuese;
- Përgatit dokumentacionin lidhur me zhvillimet e përfunduara;
- Propozon aplikime të reja për implementim;
- Bashkëpunon me grupet tjera punuese;
- Koordinon punën e vetë me udhëheqësin e njësisë;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e programeve të cilat aplikohen;
- Respekton dhe zbaton politikat dhe procedurat e bankës;
- Përveç detyrave dhe përgjegjësiave të cekura performon edhe në detyra tjera të kërkuara nga Mbikëqyrësi Direkt.

Kualifikimet:

- Fakulteti Shkencë Kompjuterike ose të ngjashme
- Mbi 2 vite përvojë pune në Teknologji Informative
- Njohja e Gjuhës Anglezë
- Gjuhët programuese – C#, Multi threaded applications, ASP.NET2.0 dhe ASP.NET 3.5, .NET framework 2.0 dhe 3.5
- Përvoja dhe njohuri në SQL, MySQL, IIS, DB2, LINQ teknologji, AJAX teknologji, AT+Sintaksa, SOAP teknologji.
- Certifikimi MCSD (Microsoft Certified Solution Developer) ose MCAD (Microsoft Certified Application Developer)

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit; hrd@bekonomike.com

Afati i aplikimit është deri më datë **14 Shkurt 2018 ora 16:00**. Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në rrethin e ngushtë do të ftohen për procedura të mëtejshme.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A
Sheshi Nënë Tereze p.n
10000 Prishtinë, Kosove

info@bekonomike.com
Tel. +381 (0) 38 500 500
Fax. +381 (0) 38 500 507



KONKURS PËR VEND TË LIRË PUNE

Banka Ekonomike, Zyra Qendrore shpall konkurs për plotësimin e vendeve të punës:

Zyrtar i Kontabilitetit (2 vende pune)
Departamenti i Financave dhe Kontrollit

Detvrat dhe përgjegjësitë:

- Fronon dokumentacionin financiar të Bankës nga koordinatori i Njesisë dhe pastaj bënë kontimin;
- Kujdeset për saktësinë e kontimit, ndryshimet eventuale të paraqitura në planin – manualin kontabël të bankës;
- Përcjell dhe kontrollon gjendjen dhe saktësinë e urdhërave të kontuara gjatë ararit dhe nxjerr dilarët e regjistrimit;
- Kryen veprimet : trezor Bankë – trezor Degë dhe trezor Degë – trezor Degë;
- Logaritë shpenzimet e udhëimit dhe likuidimin e tyre;
- Bën kontimin e faturave për mjete themelore, inventar dhe material;
- Regjistron mjetet themelore në program të kontabilitetit dhe i vendos numrat për mjetet e furnizuara të reja, përgatit fletëngarkesat si dhe e bënë barazimin e tyre me librin kryesor të Bankës;
- Përllogarit amortizimin e mjeteve themelore për çdo muaj;
- Përllogarit shpenzimet/amortizimin e parapagimeve për çdo muaj;
- Kujdeset për pagesën në afat të tatimeve dhe kontributeve në paga dhe bënë barazimin e tyre me ATK dhe TKPK dhe për çdo reklamim eventuale duhet të njoftojnë koordinatorin e Njesisë;
- Për të gjitha këto punë përgatitë urdhëresën për regjistrim në BEST;
- Lajmëron punëtorët në ATK dhe TKPK;
- Përgatit raportet mujore, tremujore dhe vjetore për tatime dhe kontribute nga pagat e të punësuarve të Bankës;
- Përpilon raporte të ndryshme për periudha të ndryshme;
- Përveç detyrave dhe përgjegjësiave të cekura performon edhe në detyra tjera të kërkuara nga Mbikëqyrësi Direkt.

Kualifikimet:

- Fakulteti Ekonomik
- Mbi 2 vite përvojë pune, preferohet përvojë bankare në financa
- Kontabilist/e e/i certifikuar
- Njohja e Gjuhës Anglezë
- Njohja e punës me kompjuter
- Të jetë në gjendje të punojë nën presion

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit; hrd@bekonomike.com
Afati i aplikimit është deri më datë **14 Shkurt 2018 ora 16:00**. Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në rrethin e ngushtë do të ftohen për procedura të mëtejshme.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A
Sheshi Nënë Tereze p.n
10000 Prishtinë, Kosove

info@bekonomike.com
Tel. +381 (0) 38 500 500
Fax. +381 (0) 38 500 507





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VIADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME/DEPARTMENT OF FINANCES AND
GENERAL SERVICES/DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJËRËZORË / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURISIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbështetur në Procedurat e Rekrutimit, njofton për anulimin e konkursit të datës 22.11.2017, për pozitën Drejtor i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore, Gjakovë, me Reference 67/2017.

OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta na osnovu procedure zapošljavanja, obaveštava o anuliranju konkursa dana 22.11.2017, o poziciji Direktora Rajonalnog Centra za Kulturnu Baštinu -Dakovica, Preporuka 67/2017.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe deponitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- ▶ Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
- ▶ Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387
- ▶ Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmi, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.
- ▶ Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qërimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshepejte

*Gjithmon me merr malli për vonën tëm
Urimë dita e pavarësisë!*

RC
cola

*Urimë perjetori i 10 Kosovë
Shpresoj që 10 vjetoria e ardhshme
fëmijet e mi kanë me qare krenar
me kësi bu në sot.*


*Ndoshta ka shumë punë që me arrit a
ka duhet por e di që këtu ka njëz që
shumë dhe kanë besim në ardhmerinë e*

**10 mesazhe
Kosovës**

*Sot 10 vjet kjo ditë ka qare anderr për n
Qe prej asaj dite une besoj që puna m
gjithmonë kthehet! Urimë Kosova jonë!
Zemra pushor, vee këtu!*

**MADE IN
KOSOVA**

*Shpresoj ma t'mirën për Kosovën
e që vitet e ardhshme t'jone ma tsuksesshm
Gëzuar perjetori i pavarësisë!*



Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.